



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 E 26 SHTATOR DHE 2 TETOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. I 26. SEPTEMBRA I 2. OKTOBRA 2013. GODINE**

**SHTATOR/TETOR - SEPTEMBAR/OKTOBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,
8. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Razmatranje Nacrta zakona o potvrđivanju članova Osnovnog sporazuma razvojne banke Saveta Evrope i učlanjenje Kosova u RBSE,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stranim investicijama,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Kosovskom institutu za javnu administraciju,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-102,
7. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Kosovske agencije za privatizaciju za 2012. godinu,
8. Izbor jednog neizvršnog člana u Bordu Centralne banke Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

E dini që në emër të Grupit janë 5 minuta, kurse në emër të deputetit 3 minuta. Vazhdojmë.

Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Desha t'ju pyes, kryetar, meqë i kemi pasur edhe dy pika të tjera, a do të jenë në vazhdim ato? Është seanca e kaluar, apo seancë e re kjo, se i kemi pasur edhe dy pika të kaluara, të cilat nuk na i sqaruat?

KRYETARI: Kryesuesi i seancës e ka mbyllur seancën e paradites. Tani jemi në seancë të re.

SHAIP MUJA: Faleminderit! Pra, sa e dimë ne, ajo nuk është mbyllur.

KRYETARI: Kryesuesi e ka mbyllur seancën. Kryesia vendos të hënën se çka do të bëhet me ato tri pika. Tani kemi seancë të re. Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Në emrin tim, kryetar. Faleminderit!

Problemit të ndërmarrjeve shoqërore “APIKO” dhe “ILIRIA” lidhur me të drejtat pronësore për rreth 23 hektarë tokë dhe Manastirit të Deçanit, për fat të keq, këto probleme kaq madhore gjithnjë hasin në vesh të shurdhër prej institucioneve tona, përkatësisht Qeverisë dhe Presidencës së vendit. Mirëpo, jemi të gjithë dëshmitarë të kësaj brengje të qytetarëve deçanas, së cilës i është shtuar edhe problemi i një aseti tjetër tepër të rëndësishëm në këtë komunë.

Deçanasit druajnë që fati i njëjtë do ta presë edhe Pushimoren e Fëmijëve në Deçan, dikur qendër rekreative e shëndetësore me renome, jo vetëm rajonale, por edhe evropiane e botërore.

Për këtë, zyrtarët e Komunës së Deçanit në vazhdimësi e kanë paraqitur këtë problem madhor, por askush deri më tash, natyrisht, në organet më të larta shtetërore nuk e pa të arsyeshme që ta ngrejë zërin dhe ta zgjidhin këtë problem. Edhe shoqëria civile në këtë komunë në vazhdimësi e ka shtruar problemin në fjalë.

Sidoqoftë, largimi i forcave paqeruajtëse të KFOR-it nga kompleksi i objekteve të pushimores “Pishat e Deçanit” dhe kthimi i saj fëmijëve të Kosovës po bëhet një proces gjithnjë e më i ndërlikuar. Moszgjidhja e drejtë e këtyre kontesteve pronësore po ndikon edhe në ngecjen e zhvillimit ekonomik në Deçan, sidomos në zhvillimin e turizmit, për ç’gjë ka potenciale si në asnjë komunë tjetër e Kosovës.

Merreni me mend, të nderuar deputetë, pas 14 vjetësh nga përfundimi i luftës në Kosovë, ne nuk jemi në gjendje t’i shfrytëzojmë potencialet tona zhvillimore, që dikur ishin krenaria e këtij vendi. Ato sot flenë, ndërsa vendimmarrësit tonë heshtin në mënyrë më të pakuptimtë, absurde dhe të pashpjegueshme.

Unë edhe një herë, në emër të të gjithë qytetarëve deçanas, i thërras institucionet e vendit, para së gjithash Qeverinë dhe Presidencën, që të mos rrinë duarkryq, por t’i rreken punës për zgjidhjen e problemeve kapitale në shtëpinë e vet, sepse mbi të gjitha besoj se për një gjë të tillë edhe e kanë mandatin nga qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vesna Nikiq.

VESNA NIKIĆ: Hvala gospodine predesdavajući!

Govorim u ime grupe.

Opština Ranilug je na jednoj od sednica, zemljište koje je bilo vlasništvo društvenog preduzeća, proglasila za zemljište od opšteg interesa, i uz to je ispoštovala absolutno sve zakonske procedure, kao i prostorni plan opštine. Odluku je takođe u određenom zakonskom vremenu prosledila ovoj vladi i to u tri navrata. Međutim, ova vlada u sva tri navrata, znači prvi, drugi i treći put ostala i gluva i nema, tako da se ovo zemljište opet našlo na tenderskoj proceduri.

S toga je opština ponovo pre tri dana prosledila zahtev ponovo lično premijeru i Kosovskoj agenciji za privatizaciju, pod oznakom “Hitno”, navodeći između ostalog da je Vlada imala za obavezu da ovo zemljište isključi iz daljeg procesa privatizacije.

Na ovaj način dovodi se u pitanje i svrha postojanja skupštine opštine, kao i izrada prostornog plana skupštine opštine, iza koje, da vas podsetim, stoji međunarodna zajednica i direktno Vlada, jer se na ovaj način direktno ugrožavaju prava i interesi opštine Ranilug, što predstavlja direktnu opasnost za promenu demografske strukture iste.

Ovom prilikom, apelujem na Vladu, na članove ove vlade, da prekinu sa praksom i činjenjem zapravo kardinalnih greški, koji će za proizvod imati nesaglediva posledice, jer će u jednom momentu moći da uništi sve ono što je svih ovih godina sagrađeno. Moram da naglasim da su građani opštine revoltirani, i da ni u kom slučaju neće prihvatiti niti primeniti ovakvu odluku.

Ovo o čemu sada govorim danas adresirala sam na jedan izvesni broj ambasada, kao i šefova poslaničkih klubova, u nadi da će nam, kao i mnogo puta do sada pomoći, jer očigledno je da je ova Vlada uzela za praksu da zakone, koji se tiču srpske zajednice, primenjuje samo uz dodatni pritisak međunarodnog faktora. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Para disa ditësh në mediet tona qarkulloi lajmi se në Kosovë aktualisht mund të jenë deri në 20 mijë përdorues të drogës. Ekspertë të sigurisë dhe organizata të ndryshme që merren me rehabilitimin e narkomanëve tregojnë për një rritje enorme të personave që e përdorin drogën në Kosovë dhe atë kryesisht persona të rinj.

Kosova më nuk konsiderohet vetëm vend transit për drogën, por fatkeqësisht edhe destinacion i saj.

Është shumë shqetësuese se edhe në shkollat tona ka filluar të përdoret droga. Sipas raportit të SPAD-it të vitit 2011 për Kosovën, një nga dhjetë nxënësit e anketuar raportojnë se mund të vijnë lehtë apo shumë lehtë deri te hashashi. Ndërkohë, gjithnjë duke iu referuar të njëjtit burim, 7% e nxënësve kosovarë raportojnë se së paku një herë e kanë përdorur ndonjë substancë narkotike. Kjo dukuri dhe shifër alarmante duhet të jetë shqetësuese, posaçërisht për njerëzit e pushtetit, ngase ata kanë obligim të krijojnë ambient jo të favorshëm për narkomaninë.

Ne e kemi rininë, për të cilën do të na kishte lakmi shumëkush, por kjo rini do orientim dhe trasim në rrugë të mirë që duhet t'i ofrohet në shoqëri.

Ndër hapat konkretë që ne si Lëvizje për Bashkim i rekomandon dhe që i kemi përmendur edhe më parë janë:

- Krijimi i një departamenti të veçantë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i specializuar për luftimin dhe parandalimin e delikuencës së të miturve,
- Në shkolla të jenë të pranishëm psikologët, por që t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre në raport me këtë problematikë të ndjeshme,
- Të ketë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet shkollave, qendrave për punë sociale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme,
- Të punohet seriozisht në aktivitetet ekstra-kurrikulare shkollore, si sportive e kulturore, të cilat do të jenë një mundësi e mirë për angazhimin e të rinjve dhe largimin nga rrugët e këqija.

Gjatë këtyre viteve të qeverisjes së vendit, për shumë gjëra jemi treguar si popull i pavëmendshëm e i papërgjegjshëm dhe i kemi lënë të marrin kahen e keqe, por, së paku në këtë pikë, duhet të jemi të vëmendshëm, të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm, sepse nuk guxojmë të lejojmë shkatërrimin e rinisë sonë, faktikisht të potencialit më të fortë që kemi për zhvillimin e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,
Kolegë deputetë,

Për këtë pjesë të rendit të ditës e shfrytëzoj rastin, po ashtu, të flas dhe ta theksoj një rast sot të shëmtuar që ka ndodhur me vrasjen e një pjesëtari të EULEX-it, në veri të vendit.

Sot, në detyrë është vrarë një doganier i EULEX-it, në kohën kur po e kryente detyrën e tij në funksion të forcimit të institucioneve të Kosovës në gjithë territorin.

Është një rast i shëmtuar i radhës. Kërkoj nga të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që sa më shpejt ta zbardhin këtë rast. Ky rast paraqet një sulm të drejtpërdrejtë në pengimin e përpjekjeve për ta vendosur funksionimin e rendit dhe ligjit në gjithë territorin e Kosovës. Është, për më tepër, një rast i rëndë për shkak se vritet një pjesëtar i një vendi, i cili vullnetarisht e kryen misionin në vendin tonë.

Kërkoj, po ashtu, që të bëjmë reagim edhe si institucion i Kuvendit, por veçanërisht kërkoj nga të gjitha institucionet e sigurisë që t'i dalin në mbështetje EULEX-it dhe po ashtu gjithë qytetarët që jetojnë atje në zbardhjen sa më të shpejtë të këtij akti të shëmtuar. Dhe, po ashtu, shfrytëzoj rastin të shpreh ngushëllime për familjen e të ndjerit dhe institucionin e EULEX-it.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Skandali i fundit me barna që ka ndodhur ka shkaktuar shqetësim te qytetarët e Kosovës. Ky skandal i radhës është dashur të merret seriozisht nga Ministria e Shëndetësisë, por edhe nga vetë Qeveria.

Arrestimet në lidhje me aferat farmaceutike sigurisht kanë ardhur pas skandalit që ka ndodhur muaj më parë, e që ndërlidhet me importin e albuminave dhe insulinave. Këto produkte dyshohen se kanë hyrë në mënyrë të paligjshme në treg. Arrestimi i kryeshefit ekzekutiv të AKPM-së dhe drejtorit të Departamentit për Licencim në AKPM, me dyshimin se këta e kanë pajisur një kompani farmaceutike me banderola për produkte mjekësore dhe pse këto produkte ishin të importuara pa licencë të AKPM-së.

Këto produkte të importuara në mënyrë të kundërligjshme janë shpërndarë në tregun e Kosovës. Të gjitha këto, natyrshëm ngrehin dilema se asnjë ilaç në Kosovë më nuk është i sigurt, derisa t'i bëhet një rievaluim gjithë dokumentacionit të produkteve farmaceutike në vend. Me urgjencë të shtetit duhet të bëhet një rievaluim masiv edhe i ilaçeve.

Për t'u bërë kjo nuk mjafton vetëm angazhimi i AKPM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Qeveria e Kosovës duhet ta shqyrtojë këtë çështje me urgjencë, nëse do që ta marrë përgjegjësinë për shëndetin dhe jetën e qytetarëve të saj.

Qytetarin duhet garantuar se nuk është duke blerë helme të licencuara nga shteti, por ilaçe. Sistemi paralel i legalizimit të ilaçeve të kontrabanduara, i krijuar nëpërmjet institucionit, do të duhej t'i kontrollonte ilaçet. Qytetarëve u ka krijuar dilemën nëse guxojnë t'i përdorin ilaçet që janë në përdorim në Kosovë.

Pas arrestimit të drejtorit të licencimit, si mund një qytetar të besojë në certifikatat e analizës që janë bashkëngjitur në këtë departament. Sa janë të dyshimta këto certifikata, sa janë të besueshme ilaçet në Kosovë, kur tash Prokuroria ka ngrehur dyshime se në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale mungojnë miliona banderola, që janë letra me vlerë, e që besohet se u janë shitur kompanive që t'i legalizojnë ilaçet e sjella në Kosovë si kontrabandë? Si mund një qytetar të jetë rehat kur blen ilaçe për fëmijët e tij dhe familjarët e tij?

Unë nuk i kuptoj deklaratimet e ministrit, i cili deklarohet se sistemi farmaceutik është i kriminalizuar, ndërsa po u beson barnave të shpërndara në tërë territorin e Kosovës, që fare nuk janë të licencuara, bile edhe më keq - edhe të paverifikuara.

Në emër të qytetarëve, i drejtohem ministrit, por edhe Qeverisë që urgjentisht të bëjë verifikimin e barnave të shpërndara në treg, në mënyrë që qytetarët të dinë nëse po marrim barna, apo helm. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILJIJA REDŽEPI: Poštovani predsedniče,
Ministri,

Uvaženi poslanici,

Poštovani građani,

Pozdravljam prve početke korake Ministarstva za ambijent i prostorno planiranje oko rušenja privatnih i društvenih objekata na Prevalcu, koji su ilegalno ili legalno izgrađeni.

Samo se Bošnjačka zajednica koja živi na tom području pribojava i apeluje na Vladu i resursne ministarstva da to ne bude nekih samo predizborni trik bilo koje političke partije, nego da se te odluke u kontinuitetu realizuju na terenu, jer se vizuelna slika turističkog nasela Prevalca pretvorila u pravo smetilište i ekološku katastrofu bez kanalizacije i vodovodne mreže, što direktno narušava i ugrožava život građana Gornjeg Sela, Mušnikova, Rećana, pa sve do samog grada Prizrena. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë dua ta dënoj fuqishëm sulmin kundër një pjesëtari të EULEX-it që është bërë sot në veri të Kosovës, nga kriminelë, të cilët, edhe pse nuk janë zbardhur autorët, tashmë e dimë se cilit komunitet i përkasin.

Ky është një sulm, jo vetëm kundër Kosovës, kundër institucioneve të Kosovës, por edhe kundër institucioneve të Bashkimit Evropian. Ky është një sulm që në fakt i vë në pikëpyetje të gjitha ato marrëveshje, të cilat gjoja janë arritur në Bruksel ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe vë në pah vullnetin ose më saktë mungesën e vullnetit nga institucionet e Serbisë, të cilat vazhdojnë t'i sponsorizojnë bandat kriminale në veri të Kosovës.

Pyetja që ngre unë është kjo: Cila do të jetë atmosfera e zgjedhjeve që do të zhvillohen në Kosovë dhe për herë të parë edhe në veri, siç po thuhet, ku do të marrin pjesë edhe serbët e Kosovës në lidhje me këto zgjedhje të Kosovës? A është kjo para prirje për një atmosferë, ku asgjë nuk respektohet, pavarësisht atyre që janë firmosur? Mendoj që edhe institucionet e BE-së, por edhe institucionet e Kosovës, duhet t'ia vënë gishtin kokës në raport me atë komunitet që po jeton atje, nga i cili në rast se flasim për qytetarët e thjeshtë, ata janë të terrorizuar nga bandat, ndërsa bandat as që duan të dinë se çfarë flitet dhe çfarë diskutohet.

E, pra, e gjithë kjo na çon tek ajo që e kemi thënë që në fillim, që çështja e veriut është çështje e sundimit të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, në emër të Grupit.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Është hera e tretë që Sekretariati i KQZ-së po vendos që bartja e votave për zgjedhje të bëhet prej një kompanie të frizerëve.

Besoni ose jo, kompania e cila edhe tash është shpallur fituese për bartjen e votave për zgjedhjet lokale të 3 nëntorit, kompania 'G&H', është e regjistruar si kompani ondulimi dhe trajtimi të bukurisë. Ky është skandal, për më keq - është skandal i përsëritur, skandal i trefishtë.

Procesi zgjedhor nuk ka nevojë për zbukurim të votave, se kjo kompani është kompani zbukurimi dhe procesi zgjedhor hiç s'ka nevojë për zbukurim të votave, por ka nevojë për siguri të tyre.

Sekretariati i KQZ-së është dashur ta shpallë operator të papërgjegjshëm këtë kompani, e jo të na arsyetohet tash se paska fituar çmimi më i lirë, oferta më e lirë në këtë tender për bartjen e votave. Bartja e votave përkatësisht, siç thuhet zyrtarisht, dhe e materialeve sensitive dhe josensitive është diçka jashtëzakonisht e rëndësishme, që nuk mund t'u besohet kompanive të cilat janë të regjistruara për trajtim të bukurisë. Edhe për më keq, ky vendim i Sekretariatit të KQZ-së sot është marrë pak ditë pasi është gjetur një kuti e humbur, e cila kishte pas humbur disi prej zgjedhjeve të vitit 2010.

Çka ua merr mendja? Kush është përgjegjës për humbjen e asaj kutie dhe mos ka edhe ndonjë kuti tjetër që paska humbur, e nuk është gjetur deri më tash? Definitivisht, ky është një skandal i përsëritur dhe Aleanca u bën thirrje organeve të drejtësisë që ta

përshejtojnë procesin, procedurën dhe punën për gjetjen dhe zbardhjen e mirë dhe të saktë të rastit të asaj kutie dhe mundësisë që të ketë edhe kuti të tjera të humbura deri tash dhe, në të njëjtën kohë, ta mbikëqyrë fuqishëm tërë procesin e bartjes së votave për zgjedhjet e 3 nëntorit. Faleminderit!

KRYETARI: A vetëm një kuti paska qenë?! Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Unë do të ngre një çështje, meqë para dy muajve në lagjen “Sefa” në Gjakovë janë djegur pesë shtëpi të komunitetit egjiptian. Pra, ato shtëpi janë shkatërruar dhe djegur, e shkak kryesor ka qenë rryma.

Mirëpo, problemi kryesor është që në këto familje ka ndodhur një problem dhe se mund të themi lirisht se ekipi i zjarrfikësve ka shkuar atje në mënyrë shumë të papërgatitur. Me autocisternat e tyre ata kanë shkuar diku me nga 25 litra ujë, që do të thotë se në praninë e tyre janë djegur edhe shtëpitë, dhe që do të thotë se institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarin masa, e të mos na gjejë diçka më tepër, ndonjë katastrofë, sepse vetëm jemi në duar të Zotit, sepse sa u përket institucioneve ato janë duke fjetur.

E dyta, është që Qeveria e Kosovës ishte e lajmëruar për këtë rast, personalisht isha te ministri për Komunitete dhe Kthim dhe ato familje janë nën qiellin e hapur dhe tash pasi po afrohet dimri duhet të ndërmerren masa. Unë nuk di sa muaj duhet të ekzistojnë procedura që ministri për Komunitete, që është ministër i gjithë qytetarëve të Kosovës dhe i gjithë komuniteteve, duhet të intervenojë në këto shtëpi?

Unë besoj që nuk duhet të ketë segregacion në këtë vend dhe nuk duhet që disa komunitete të anashkalohen. Pra, dua ta parafrazoj Xhon Kenedin, që para shumë vjetëve pati thënë nëse shkelen të drejtat e një njeriu, ose një komuniteti, do të shkelen të drejtat e të gjithë qytetarëve.

Prandaj, edhe unë po them se qytetarët e Kosovës të gjithë janë të barabartë, komunitetet në Kosovë të gjitha janë të barabarta, por jo vetëm në Kushtetutë dhe në letër, por duhet që Qeveria edhe të veprojë. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka më të paraqitur. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

I kemi pesë pyetje, po asnjëri nga ministrat të cilëve u janë drejtuar pyetjet nuk janë të pranishëm. A doni t’i parashtroni pyetjet? Alma Lama i ka dy pyetje për kryeministrin Thaçi dhe për ministrin Hoxhaj.

Urdhëro, merre fjalën për pyetjen e parë.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime të cilën e kam parashtruar herën e kaluar për kryeministrin mbetet e njëjta, arsyeja se përse është larguar nga posti zëvendësministri i FSK-së, Slavisha Filipović, i cili, siç e kam theksuar disa herë në Kuvendin e Kosovës, është kapur duke dërguar informacione, të dhëna për armatimin e FSK-së, por edhe të dhëna të tjera në Beograd. Do të doja të di nëse motivi zyrtar i largimit të tij ka të bëjë pikërisht me këtë veprim, i cili përbën spiunazh dhe është vepër e dënueshme në bazë të Kodit Penal?

Kryeministri nuk ishte as atëherë dhe nuk është as tani, kështu që i bie që nuk dëshiron të tregojë se pse e ka shkarkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi nuk është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu i ka dy pyetje, për ministrin Besim Beqaj dhe për Nenad Rashiqin. Deputet, do t'i bësh pyetjet? Regjia, fjalën deputeti Bekim Haxhiut.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të dy pyetjet i procedoj për seancën e radhës, kur të jenë ministrat këtu.

KRYETARI: Të pranishëm janë 37 deputetë. Tani na duhet votimi, por nuk kemi numra për votim.

Edhe për këtë seancë, Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare, do të vendosin të hënën. Mirupafshim!

* * *

Më 26 shtator 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 19 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE

Të pranishëm 67 deputetë. Kërkoj nga regjia t'i bjerë ziles dhe deputetët të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e incizimit)

Në sallë janë 76 deputetë prani fizike, 83 prani elektronike.

(Ndërhyrje)

Pra, po kalojmë në ligj, mirëpo ministrat s'i kemi këtu. Atëherë, do ta bëjmë një pauzë deri në orën 14:30 minuta.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Zotërinj deputetë,
Fillojmë punën! Ma jep atë letrën, sa njerëz janë këtu?

Pikën 3 të rendit të ditës nuk do të vazhdojmë, sepse na duhet kuorum prej 80 deputetësh, që ashiqare nuk janë momentalisht, këtu. Do të rikthehemi, nëse bëhet kuorumi në këtë numër.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ, shkurtimisht të paraqes: qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për investime të huaja.

Ligji numër 02/L-33 për investime të huaja është miratuar në Kuvendin e Kosovës, me datë 21 nëntor 2005. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës ka hyrë në programin legjislativ 2013 miratimi i Ligjit të ri për investime të huaja.

Qëllimi i hartimit të këtij projektligji është:

- Që t'u ofrohet mbrojtje investitorëve të huaj;
- Të krijohen kushte, në mënyrë që investitorët të mos favorizohen apo diskriminohen kundrejt investitorëve lokalë;
- Të njihen investimet nga diaspora kosovare si investime të huaja si dhe të rritet e efikasiteti i Agjencisë Kosovare për Investime dhe Ndërmarrje, duke i bashkuar dy agjenci në një, atë të promovimit të investimeve në Kosovë, si dhe Agjencinë për Mbështetjen për ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Ligji i ri rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë në krahasim me ligjin aktual që rregullon vetëm inkurajimin dhe nxitjen e investimeve të huaja në Kosovë.

Ky projektligj është përgatitur së pari nga grupi punues i brendshëm formal i themeluar me vendimin e sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në këtë grup të brendshëm krahas zyrtarëve të MTI-së kanë marrë pjesë edhe Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, Banka Botërore, INDEP-i dhe të gjithë e kanë përkrahur projektligjin që gjendet para jush sot, të nderuar deputetë.

Ndryshimet në këtë projektligj kanë ardhur edhe si rrjedhojë e tryezës për investime të huaja, të organizuara nga shoqëria civile, ku kanë qenë të pranishëm deputetë nga pozita dhe opozita. Pothuajse të gjitha komentet e pranuar janë inkorporuar në këtë projektligj.

Projektligji është përgatitur në përputhje të plotë me legjislacionin ndërkombëtar, evropian dhe praktikat më të mira dhe për këtë kemi pranuar dhe dritën e gjelbër nga institucionet relevante, përfshirë Bankën Botërore, ITC-në dhe Zyrën e Bashkimit Evropian.

Risitë në këtë projektligj janë:

- Në investime të huaja janë përfshirë edhe investimet e diasporës, gjegjësisht shtetasve të Kosovës, që jetojnë jashtë vendit dhe do të konsiderohen si investitorë të huaj.
- Edhe diaspora do t'i gëzojë të gjitha të drejtat dhe privilegjet që i gëzojnë investitorët e huaj.
- Çdo qytetar i Kosovës që ka jetuar për më shumë se dy vjet jashtë Kosovës, do të konsiderohet si investitor i huaj edhe nëse nuk posedon nënshtetësi të huaj.
- Si risi tjetër e projektligjit është, se Kosova do t'u japë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre trajtim të njëjtë dhe të barabartë me investitorët vendorë dhe investimet vendore.
- Investitorët e huaj dhe investimet e tyre do të jenë në pajtim dhe do të kenë të drejta dhe obligime me ligjin e aplikueshëm në Kosovë njëjloj sikurse investitorët vendorë dhe investimet e tyre.

Ky ka qenë edhe rekomandim dhe propozim i deputetëve, që është përfshirë në këtë projektligj.

Është me rëndësi që ky projektligj u ofron mbrojtje të plotë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, duke iu ofruar siguri, se të drejtat e tyre krahas legjislacionit vendor do të mbrohen në përputhje me konventat ndërkombëtare në fushën e investimeve të huaja.

Në këtë projektligj është propozuar dhe paraparë se investimet e huaja nuk do të eksproprijohen apo nacionalizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nuk do të jenë objekt i ndonjë mase të barasvlershme me to, me përjashtim të rasteve të veçanta në interes të përdorimit publik të përcaktuar me ligj, pa diskriminim, me kompensim të menjëhershëm të përshtatshëm dhe efektiv në përputhje me procedurat ligjore.

Me projektligjin e ri, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër apo mjet juridik që investitori mund t'i ketë, investitori i huaj ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës ose arbitrazhit për

kompensim për dëmet dhe harxhimet e krijuara si pasojë e çdo veprimi apo mosveprimi që është drejtuar kundër investitorit të huaj dhe që është një shkelje e ligjit të aplikueshëm në Kosovë apo të normave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe që i atribuohen Kosovës.

Si risi shumë e rëndësishme e këtij projektligji është paraparë Instituti i parimit të heshtjes administrative. Heshtja është pranim, do të aplikohet në rast se investitori i huaj ndërmerr një aktivitet apo veprim biznesor të llojit të caktuar, pa marrjen e aprovimit nga ana e organit kompetent, nëse një aprovim apo refuzim i kërkesës nuk është dhënë në kuadër të kufizimeve kohore, të paraparë me legjislacionin në fuqi.

Në këtë projektligj është paraparë se në rast të konfliktit të armatosur dhe trazira qytetare, Kosova do të trajtojë atë investitor të huaj apo person të huaj, sa i përket kompensimit apo zgjidhjes tjetër, trajtim të njëjtë dhe të barabartë me ndonjë investitor vendor dhe investime vendore.

Në këtë projektligj është paraparë mbajtja e regjistrit të investimeve të huaja, me të cilin Ministria do të mbajë një regjistër për të gjithë investitorët e huaj dhe investimet e huaja.

Projektligji rregullon promovimin e investimeve dhe për këtë arsye parasheh themelimin e Agjencisë Kosovare për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve.

Agjencia është një institucion në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është përgjegjëse:

- Për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve të huaja,
- Mbështetjen e politikave dhe programeve publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme,
- Promovimin e produkteve vendore jashtë Kosovës, si dhe zhvillimin e politikave lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike.

Projektligji i ri në shumë nene parasheh riformulime të neneve në përputhje me zhvillimet e fundit legjislativë që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës. Ky projektligj në rrethana normale është dashur të propozohet si plotësim dhe ndryshim i ligjit ekzistues, për arsye se nuk i tejkalon 40% të ndryshimeve, por duke pasur parasysh se ligji aktual është pak më i vjetër dhe në shumë raste thirret edhe në dispozita të UNMIK-ut, ne e kemi shkruar si një ligj të ri dhe kemi harmonizuar me sistemin juridik të Republikës së Kosovës, duke i ikur dispozitave juridike të UNMIK-ut, gjë që është synim i sistemit të juridik të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e projektligjit në fushën e ekonomisë dhe me qëllim që t'u ofrohet mbrojtje investimeve të huaja dhe të krijohen kushte dhe lehtësira për tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë, duke pasur parasysh se ky projektligj i propozuar është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë plenare. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Zonja ministre,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për herë të tretë e ka shqyrtuar këtë projektligj të ardhur nga Qeveria. I kemi trajtuar po ashtu edhe ato çështje që janë debatuar në Komision edhe herëve të tjera dhe tash së fundmi.

Komisioni ka miratuar në parim këtë projektligj dhe unë i ftoj deputetët dhe grupet parlamentare që ta miratojnë.

Kërkoj po ashtu, nga grupet parlamentare dhe deputetët, që të kontribuojnë në Komision, meqenëse ka pasur dy herë të tjera vërejtje dhe debate për këtë projektligj, që ta japin kontributin e tyre në Komision, në mënyrë që ky projektligj të dalë sa më mirë në leximin e fundit ose në aprovimin e fundit.

Po ashtu, konsideroj që edhe pse është ky projektligj ndër të rrallët, se ka pak vende, është një përpjekje për të krijuar një klimë më të mirë administrative dhe juridike për të gjitha bizneset që dëshirojnë të veprojnë në Kosovë. Mendoj që është një rast i mirë për ne si Kuvend që ta nxjerrim këtë projektligj sa më të mirë.

Ju ftoj ta aprovonit dhe po ashtu, në emër të Komisionit ju ftoj që të jepni kontributin tuaj të gjithë pa dallim në Komision dhe grupin punues. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Kolege dhe kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka mbështetur edhe më herët dhe mbështet edhe tani Ligjin për investime të huaja.

Nuk dëshiroj të përsëris qëllimin e ligjit dhe risitë që janë tani në këtë draft, se ato veç sa i përmendi ministria e Tregtisë dhe Industrisë, por më lejoni t'i ritheksoj politikat e BE-së dhe asquis communautaire sa i përket fushës për investime të huaja.

Fusha e Projektligjit për investime të huaja për shtetet anëtare të BE-së nuk është e rregulluar me legjislacionin e BE-së, me çka i është lënë atyre që ta rregullojnë në bazë të politikave të tyre të brendshme.

Sipas Komisionit Evropian, parimet kryesore të BE-së për investimet e huaja janë fokusi në investimet afatgjata që gjenerojnë punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim çka i duhet Kosovës urgjentisht, një punësim dhe zhvillim i qëndrueshëm, mandej përmirësimi i qasjes në treg dhe sigurimi i investimeve të huaja, që si në fazën para themelimit ashtu edhe pas themelimit do të trajtohen si ato të brendshmet.

Nuk është e tepërt të ritheksohet se me këtë draft që tani është sjell me disa ndryshime, vlen të përmendet se kanë një lehtësirë të investimeve dhe qytetarët tanë që jetojnë në diasporë.

Ne si grup parlamentar e mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit në komisionet përkatëse. Ju ftoj, kolegë deputetë, që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Ministre,

Ministër,

Kolegë deputetë,

LDK-ja vazhdon ta mbajë qëndrimin nga dy seancat e kaluara se ligji prapëseprapë nuk i plotëson apo nuk i adreson të gjitha çështjet, të cilat janë përmendur në seancat e kaluara. Shohim që ka disa ndryshime, por që nuk janë të asaj rëndësie që ne do të duhej ta votonim ligjin.

E para ka të bëjë me ndryshim që është zbritja e përqindjes së investimit të huaj në investimet e përgjithshme, që do konsiderohet si investitor i jashtëm prej 28-10%.

Duhet ta analizojmë, kjo zbritje të themi- a u bën mirë investimeve aktuale, apo jo? Megjithatë, si propozim, besoj se do ta shqyrtojmë më shumë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik.

Çështje tjera, të cilat edhe herën e kaluar janë përmendur, por që mbesin si vërejtje të LDK-së janë ato që kanë të bëjnë me fuzionimin e dy agjencive aktuale. Edhe njëherë po e përsëris, LDK-ja nuk e ka problem fuzionimin e atyre agjencive, por mendojmë se nuk është mënyra më e mirë për fuzion, anulimi i një ligji apo fuzionimi i dy agjencive nëpërmjet një ligji tjetër.

Domethënë, fuzionimi i dy agjencive, shfuqizimi i një ligji tjetër që ka të bëjë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbetet brengë jona, për shkak se është një lëmi e cila rregullohet me ligje të caktuara dhe duhet thjesht të përkrahet sa më shumë duke marrë parasysh që ne afër 98 – 99% të bizneseve i kemi ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Vërejtje tjetër mbetet shfuqizimi i Këshillit të investitorëve të jashtëm, që është pranë Zyrës së Kryeministrit. Ne besojmë se ai Këshill luan rolin e posaçëm në shprehjen e

mendimeve të tyre për klimën e biznesit, është një forum i cili do t'i ndihmojë cilësdë Qeveri në krijimin e legjislacionit.

Në esencë, themi ligji nuk i shqyrton problemet aktuale që janë në fushën e investimeve të jashtme, në tërheqjen e investimeve të jashtme, që themi se janë problemet ekonomike dhe ato politike, që të mos hyjmë në detale e t'i sqarojmë cilat janë ekonomike e cilat politike, nëse nuk adresohen problemet aktuale dhe nuk shohim një avancim të ligjit në këtë fushë, ne mendojmë se ky ligj prapë duhet t'i kthehet Qeverisë për hartim të ri. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!

Siç u tha edhe nga parafolësi edhe nga të tjerët që folën, është hera e tretë që po e diskutojmë të njëjtin ligj dhe pak a shumë duhet të thuhet se shumë pak ka ndryshime në të, të cilat do të ishin të natyrës substanciale, siç janë kërkuar pra edhe në seancat që janë mbajtur kur është diskutuar kjo pikë e rendit të ditës, po edhe në ato tryeza që i përmendi ministria, ku është diskutuar natyrisht e tërë logjika e investimeve edhe investime të huaja në veçanti dhe si do të duhej të konkretizohej ajo me një ligj të caktuar.

Dhe, ato vërejtje të shumta që i kemi pasur në seancë, nuk janë përfshirë as në logjikën e as në shkronjën e ligjit, gjë që e bën ligjin prapë t'i bartë të njëjtat rreziqe që i kemi përmendur edhe më herët dhe që na obligon t'i përsërisim edhe njëherë ato që i kemi thënë më herët. Sepse, qartazi Qeveria nuk e ka ndërmend për të dëgjuar për këto punë.

Edhe Lëvizja "Vetëvendosje" e konsideron këtë ligj të jetë po aq i dëmshëm dhe po aq i rrezikshëm sa që ka qenë edhe në dy versionet e tij të para dhe rrjedhimisht do ta votojmë kundër ligjin. Ose më mirë të them, do të ishte mirë që Qeveria vërtet t'i thërret mendjes, në këtë rast Ministria e Industrisë dhe Tregtisë dhe ta tërheqë ligjin, në mënyrë që ta bëjë një ligj me të cilin do të pajtoheshin deputetët, po këta nuk po duan ta bëjnë një gjë të tillë, që na obligon pastaj që të votojmë kundër, si mekanizëm për t'i treguar edhe njëherë Qeverisë që nuk ka pajtueshmëri për ligjin në tërësi dhe logjikën që ky ligj e përcjell.

Është e vërtetë që investimet e huaja natyrisht që janë një prej si të them mekanizmave goxha të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të një vendi, veçanërisht një vendi siç është Kosova e i cili ka probleme të theksuara edhe me akumulim kapitali, por edhe përgjithësisht me sektorin e industrisë dhe prodhimitarisë.

Mirëpo, investimet e huaja jo domosdoshmërisht dhe nuk janë apriori të mira për një vend të caktuar, ato mund të bëhen të mira me politika të Qeverisë apo mund të bëhen edhe të dëmshme, po që se mungon kjo politikë, po që se Qeveria aplikon politika të mbrapshta, siç është rasti i Qeverisë së Kosovës dhe siç është rasti veçanërisht me këtë ligj për investime të huaja, ku shihet qartë se Qeveria e Kosovës në fakt, është e interesuar që ta hapë derën plotësisht për investime të huaja, pa marrë kurrfarë mase në mënyrë që t'i drejtojë dhe obligojë këto investime drejt zhvillimit dhe çka është më me rëndësi, rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Pra, është ligj i cili shumë më shumë, 100% në tekstin e vet është i bazuar në interesin dhe përfitimet që mund t'i nxjerrin investitorët e huaj e shumë pak, madje fare në interesin e Kosovës dhe çfarë interesi do të kishte Kosova nga këto investime të huaja.

Duhet t'i përmend vetëm disa. Është parimi i mosdiskriminimit, që është pjesë përbërëse e këtij ligji, pra mos diskriminimit karshi investitorëve të huaj dhe ky mos diskriminim shtrihet jo vetëm në sektorë të veçantë të ekonomisë, por edhe në vendet e origjinës së investitorit, llojin e kapitalit dhe përgjithësisht natyrën e investimit dhe ky parim i mos diskriminimit, natyrisht që pastaj shndërrohet në njëloj diskriminimi të ri, i cili është jo vetëm diskriminim karshi investitorëve të vendit, për shkak se këtu flitet vetëm për investitorë të huaj, ndërkohë që ne nuk kemi kurrfarë rregulla se si i trajtojmë investitorët e vendit.

Por, në anën tjetër është edhe diskriminim ndaj Kosovës në përgjithësi, duke pasur parasysh që ne etablojmë një politikë, e cila është e sheshtë, pra mos diskriminuese karshi të gjitha vendeve, kur e kemi parasysh në të njëjtën kohë që jo të gjitha vendet kanë qasje të njëjtë apo pozicion të njëjtë karshi Kosovës. Dhe, ne pra nuk i diskriminojmë edhe vendet që na diskriminojnë, që nënkupton që në fakt ne vetë po e sanksionojmë një padrejtësi që na bëhet ne.

Pra, po sillemi njëjtë me ata që na diskriminojnë dhe me ata që nuk na diskriminojnë dhe natyrisht që sjellja dhe qasja e një shteti nuk mund të jetë e njëjtë karshi shteteve duke pasur parasysh që ato shtete nuk kanë pozicion të njëjtë karshi Kosovës. Për shembull, ne nuk mund ta trajtojmë njëjtë, sikur ta zëmë një investitor, ose sikurse Serbinë dhe apetitet ekonomike që Serbia i ka karshi Kosovës sikur të një vendi tjetër që ka qasje miqësore ndaj Kosovës.

Dhe, ky mos diskriminim që ne ua bëjmë atyre, përveç që në njëfarë mënyre dërgojnë një sinjal të gabuar karshi tyre, e dëmtojmë edhe veten.

Në anën tjetër, një çështje që i mungon këtij ligji e që është shumë e rëndësishme, është nuk ka kurrfarë definimi të asaj që mund të quhet siguri në investime. Pra, cilët janë ata sektorë ekonomikë të Kosovës, në të cilët Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë masa, të mos lejojë që ato të kalojnë në duar të investitorëve të huaj, për shkak të nivelit të sigurisë, që mund të paraqesin këta sektorë për ekonominë e gjithëmbarshme të Kosovës dhe veçanërisht edhe për sovranitetin e Kosovës?

Pra, në Ligjin për investime të huaja nuk ka një definim të tillë e kjo është praktikë normale, që e ndjekin shumica e shteteve të Bashkimit Evropian. Pra, janë disa sektorë ku shtetet e Bashkimit Evropian nuk lejojnë investime të huaja, janë të përjashtuara investimet e huaja nga ata sektorë, ndërkohë, që në Kosovë këto investime të huaja janë të garantuara kudo që ato duan të hyjnë. Dhe, kjo nënkupton edhe njëherë se si Kosova heq dorë nga mundësia për t'i orientuar investimet e huaja në ata sektorë, në të cilët vërtet Kosova ka nevojë për kapital të huaj që të investohet dhe në anën tjetër, të cilët do të gjeneronin edhe vende të reja të punës, po edhe do të gjeneronin zhvillim ekonomik në përgjithësi edhe rritje të mirëqenies së qytetarëve. Pra ky është ai lloj drejtimi i

investimeve të huaja në të mirë dhe në interes të vendit, që Ligji për investime të huaja jo që nuk e bën, por në fakt ia pamundëson Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës, që ta bëjnë një gjë të tillë.

Për sa u përket kufizimeve të cilave duhet t'i nënshtrohen investimet e huaja këtë e ka praktikuar dhe e praktikon, për shembull, Republika Federale e Gjermanisë, pastaj Franca dhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian, pra ekonomi kaq të mëdha të Bashkimit Evropian, të cilat megjithatë kanë ndërmarrë masa që mos t'i lënë investimet e huaja apo sektorë të caktuar, kompani të caktuara, të kalojnë në duar të investitorëve privat. Për ta marrë një rast dhe një shembull ndoshta nga Kosova, për shembull, rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike. Në asnjë mënyrë kjo nuk bën të kalojë dhe të menaxhohet nga kapitali apo investimi i huaj, aq më tepër kur ne me Ligjin për investime të huaja praktikisht e pamundësojmë çfarëdo intervenimi të Qeverisë së Kosovës në këtë kompani.

Dhe, nëse një ditë investitori i huaj vendos që ta pezullojë angazhimin e vet ekonomik, ta zëmë në KEC, atëherë kjo nënkupton që Kosova thjesht nuk do të ketë rrymë, sepse nuk do të ketë rrjet për ta shpërndarë këtë energji elektrike. Dhe, me Ligjin për investime të huaja, Qeveria e Kosovës nuk ka se çfarë të bëjë në këtë drejtim, sepse nacionalizimi i pronës është i ndaluar me këtë. Pra, në njëfarë mënyre ne po rrezikojmë që tërë shteti ynë të na kontrollohet nga investimet e huaja për shkak se po i hapim derë që ato të investohen kudo. Dje, në KEC, nesër në PTK, pasnesër në minierat e Kosovës, e kështu me radhë. Dhe, kjo nënkupton që në fakt e tërë ekonomia e Kosovës do të kontrollohet nga kapitali privat që vjen nga jashtë dhe kjo do të nënkuptojë që në njëfarë mënyre qytetarët e Kosovës dhe përgjithësisht edhe institucionet politike të Kosovës, do të jenë këtu sikur banorë me qira, pra do të jenë këtu sikur në shtëpinë e huaj.

Dhe, unë mendoj që nuk jemi në aso situatë, që me vetë dëshirë dhe vullnet të lirë, siç po paraqitemi këtu në Kuvend, ta miratojmë një ligj, i cili praktikisht nënkupton njëlloj kapitullimi të Kosovës karshi kapitalit privat, pa pasur kurrfarë mekanizmi që në njërën anë ta selektojmë atë kapital dhe në anën tjetër ta orientojmë atë kah investimet, të cilat vërtet na interesojnë neve dhe të cilat vërtetë do të na zhvillonin neve. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Ramiz Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar këtë ligj dhe i sugjeron grupit të vet parlamentar që të mos e përkrahë, për arsye se ky ligj po tenton ta prolongojë agoninë e qytetarëve të Kosovës, duke shpresuar që me këtë ligj do të hapen dyert e investitorëve të huaj, të cilët edhe me ligjin e kaluar nuk janë askund dhe ky ligj nuk do t'i sjellë.

Është ndoshta një veti e mirë që u garanton bashkëqytetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në Evropë, që do t'u sigurohet edhe atyre kapitali investues, por edhe ata nuk janë duke investuar këtu, për arsye se këtu nuk mund të investohet dhe nuk mund të punohet për

arsye të korrupsionit të madh dhe duke e ditur se edhe vetë investitorët e brendshëm janë duke u persekutuar maksimalisht dhe pakënaqësia e tyre reflekton drejtpërdrejt në pakënaqësinë e investitorëve të huaj që vijnë këtu në Kosovë, për arsye se shumica e tyre konsultohen me investitorët vendës, të cilët u sugjerojnë se ata nuk kanë vend, për arsye se edhe vetë investitorët e brendshëm nuk janë të kënaqur.

Prandaj, këtu duhet të krijohet një ambient i mirë investues, jo i korruptuar, në mënyrë që të sillen investitorë tjerë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!
Përshëndetje për ministren dhe ministrin që janë të pranishëm këtu, për dy ministrat, se s'e paskam parë ministrin Beqaj.

Duke marrë parasysh se Ligji për investime të huaja vjen si projektligj për herë të tretë brenda Kuvendit të Kosovës dhe duke marrë parasysh se Kosova gjendet në prag të zgjedhjeve lokale, kjo po shihet që po reflekton edhe në ligje. Në rast se duam ta ndërtojmë Kosovën, atëherë çështja e ndërtimit të Kosovës vjen po nga investimet e huaja dhe jo nga Buxheti i Kosovës.

Pra, është një vend ku mund të plotësohet e ndryshohet ligji- Kuvendi i Kosovës. I marrim të gjitha sugjerimet e të gjitha grupeve parlamentare, unë ju kam thënë edhe brenda Komisionit Parlamentar, në rast se s'jeni të kënaqur me projektligjin i cili ka ardhur për herë të tretë në Kuvend të Kosovës, atëherë është Kuvendi, organi më i lartë i shtetit, ku ne kemi të drejtë ekskluzive të ndryshojmë mbi 40% të projektligjit. Dhe, ta bëjmë një projektligj edhe për investitorët vendorë apo për qytetarët tanë që janë në diasporë edhe për investitorët e huaj një herë e përgjithmonë një klimë e mirë për investitorë dhe t'u jepet mundësia edhe qytetarëve tanë të punojnë nëpër organizata të cilat prodhojnë e jo nëpër organe qeveritare.

Koalicioni për Kosovë të Re jep përkrahje, ndërsa të gjitha sugjerimet, si nga opozita dhe nga pozita janë të mirëseardhura për një projektligj, se nuk ndërtohet një projektligj për dy parti në Qeveri, por ndërtohet për të gjithë qytetarët e Kosovës, që të implementojmë në amendamentimin e këtij projektligji, që të gjejmë një ligj shumë të mirë edhe për investitorët vendorë edhe për investitorët e huaj dhe të ruhet çështja e shtetit të Kosovës, që është çështje me e rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Veç dua të them që ne nuk e kemi me përqindje, se sa mund ta ndryshojmë ligjin. Ne si Kuvend ligjin mund ta ndryshojmë edhe 100%. Në emër të "6+", s'është lajmëruar kurrkush. Në emër të SLS-së, s'është lajmëruar kurrkush. Në emër të "Zajednička Budućnost", s'është lajmëruar kurrkush.

Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar ministra,

Duke marrë parasysh shpresat që ka vendi për përmirësimin e ambientit të biznesit, stabilizimin e mjedisit makroekonomik, resurset natyrore që kemi në posedim dhe çmimin e ulët të fuqisë punëtore, Kosova ka të gjitha premisat për t'u bërë një vend shumë atraktiv për investime të huaja.

Por, megjithatë politikëbërësit tanë duhet të kenë parasysh se kjo nuk mund të arrihet nëpërmjet një ligji që ne sot kemi para vetes, ligj ky i cili nuk adreson pjesën më të madhe të problemeve që duhen zgjidhur dhe pengesave e barrierave, që duhet eliminuar, në mënyrë që të jemi sadopak atraktivë për investitorë të huaj.

Sipas raportit të Bankës Botërore, për të bërë biznes të vitit 2011, Kosova prinë në krahasim me vendet fqinje për çmimin e ulët të fuqisë punëtore, por a mjafton kjo? Natyrisht që jo.

Problem mbi probleme në vendin tonë është mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse zhvillimore, e cila do të shkoqiste qartë se ku dëshirojmë të shkojmë, cili është qëllimi, cili është vizioni, cilat janë prioritetet zhvillimore të Qeverisë, cilat janë barrierat dhe si do të adresohen ato brenda afateve të caktuara kohore?

Mungesa e një strategjie të tillë ka si konsekuencë një strategji për promovim të investimeve, e cila është tejte e përgjithësuar. Ajo duhet të kanalizohet dhe të vë theksin në sektorë të caktuar. Agjencia për Promovim të Investimeve, cilido qoftë ai, i fuzionuar apo jo i fuzionuar, duhet më tepër të fokusohet në sektorët të cilët nuk mbulohen nga kapitali vendor dhe ekspertiza vendore.

Sektorët që performojnë mirë tani nuk duhet të jenë atraktivë sikurse sektorët tjerë. U përmend nga parafolësit edhe sektorët e sigurisë dhe u përmend në me shumë vend sektori i energjisë se çfarë ka ndodhur me këtë sektor, pikërisht për shkak të hapjes së dyerve dhe krahëve investitorëve të huaj pa pikë kriteri.

Ne propozojmë që Qeveria, përpos ligjit të ridizajnojë një pako të insentivave ose stimujve fiskalë dhe financiar, që u dedikohen investimeve të huaja. Këto insentiva duhet t'u dedikohen investitorëve të huaj të cilët ndihmojnë ta zbusin normën e papunësisë, do të thotë në sektorët që përdorin më shumë fuqi punëtore.

Të gjitha studimet e bëra deri më tani tregojnë se barriera kryesore në tërheqjen e investimeve të huaja është korrupsioni. Dhe kjo nuk është barrierë vetëm në tërheqjen e investitorëve të huaj, por është barrierë e çdo progresi në ekonominë e Kosovës.

Tanimë kjo mund të gjendet në shumë raporte ndërkombëtare dhe emri Kosovë tani kur ne kërkojmë në Google, është në asociacion me emrin korrupsion. Këtë gjë e gjejmë në raportin e Komisionit Evropian për studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në faqen 15, ku thuhet se ekonomia informale dhe korrupsioni janë sfida për

zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kur investorët e huaj lexojnë raporte të tilla shumë kredibile, atëherë çfarë mund të mendojnë ata për të investuar kapitalin e tyre në Kosovë? UNDP-a në raportin e paralajmërimit të hershëm konstaton po të njëjtën gjë në vitin 2013.

Dhe, çfarë po bën Qeveria? Pyetja është çfarë po bën Qeveria për ta luftuar këtë dukuri?

Faktikisht, nuk po bën asgjë, sepse e ka përfshirë nga brenda, si një epidemi.

Për të pasur sadopak sukses në tërheqjen e investimeve të huaja, strategjia kundër korrupsionit e cila me shumë vërejtje u miratua në këtë Kuvend, duhet të implementohet pa vonesë. Duhet të gjendet vullneti politik për implementimin e kësaj strategjie kundër korrupsionit, në mënyrë që vendi të dërgojë një sinjal të qartë te investorët dhe te diaspora, të cilët me shumë dëshirë do të investonin në vendin e tyre.

Po të kthehemi prapë te fuqia punëtore, Kosova si vendi me popullsinë më të re duhet të ndërtojë ura lidhëse ndërmjet sistemit të edukimit dhe theksit në tërheqjen e investimeve të huaja dhe sektorëve me prioritet për zhvillim ekonomik. Të gjithë pjesëmarrësit në tregun e huaj duhet të kenë kualifikimet minimale, në mënyrë që ky treg të jetë sadopak atraktiv.

Kosova ka një përqindje të investimeve në edukim, në raport me GDP-në relativisht të njëjtë me vendet fqinje, por për shkak se ne kemi një popullsi të re, investimet në edukim për kokë të nxënësit dhe studentit janë shumë të ulëta në krahasim me vendet e rajonit. Në këtë aspekt, Kosova duhet të ketë një strategji orientuese dhe të dijë se çfarë duhet të ofrojnë institucionet publike arsimore dhe ato private, si në aspektin akademik, ashtu edhe në aspektin profesional.

Kur jemi te tërheqja e investimeve të huaja edhe tregu i vogël në Kosovë mund të shihet si barrierë. Në teorinë ekonomike tërheqja e investimeve të huaja është funksion i madhësisë së tregut të vendit nikoqir, i matur gjithashtu me vlerën e përafërt të GDP-së. Por, në këtë rast, meqenëse Kosova është nënshkruese e CEFT-as, kjo nuk duhet të shihet edhe si barrierë.

Barrierë tjetër nga studimet dhe nga deklaratat e investorëve të huaj është parë edhe puna e munguar e Agjencisë për Promovim të Investimeve. Në një studim që Oda Ekonomike ka paraqitur vetëm para një jave, thuhet se vetëm 4.8% e investorëve të huaj informatat i marrin nga institucionet shtetërore, kurse pjesa tjetër kthehen tek resurset sekondare, siç janë odat ekonomike, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe IBRD-ja.

Qeveria duhet të definojë qartë fushat e përgjegjësisë dhe t'i eliminojë përpjekjet e dyfishta dhe të pakoordinuara ndërmjet agjencive që shihen si pika të kontaktit për investorë të huaj. Në këtë aspekt organizmat institucional si Agjencia për Promovim të Investimeve, Agjencia e Privatizimit, odat ekonomike, Banka Qendrore e Kosovës dhe agjencitë për zhvillim dhe kërkime duhet, të jenë mirë të informuara dhe të koordinuara.

Është shqetësues fakti se disa nga informatat që kanë të bëjnë me profilin e vendit, nuk janë të harmonizuara dhe janë të ndryshme nëpër institucione të ndryshme, duke krijuar kështu huti të madhe ndërmjet investitorëve të huaja.

Për momentin edhe me ligjin e propozuar promovimet dhe tërheqja e investimeve është e centralizuar dhe për të pasur sukses nevojitet që të ndodhë njëlloj decentralizimi në nivelin lokal. Shumë komuna e kanë fatin që të jenë të pasura me resurse të ndryshme natyrore dhe njëkohësisht përballen me norma të mëdha të papunësisë, derisa bashkëpunimi ndërmjet të nivelit qendror dhe atij lokal është jo në nivel të kënaqshëm, është shumë burokratik dhe është politik, është e nevojshme që komunat të ketë mjetet dhe instrumentet e veta për stimulim të investimeve të huaja, sidomos investimeve që vijnë nga diaspora.

Gjithashtu, Qeveria ka nevojë që të jetë e vetëdijshme për efektin e investimeve të huaja në ekonominë reale. Në një numër të madh të raporteve, siç janë raportet e Odës Ekonomike, të Bankës Qendrore, të Agjencisë së Promovimit të Investimeve, të gjitha këto raporte fokusohen shumë në monitorimin e trendëve, barrierave, ngritje-zbritje të investimeve të huaja, por nuk ka asnjë raport i cili tregon, nuk ka asnjë përpjekje nga ana e Qeverisë, që tregon efektin real të investimeve të huaja.

Ne mund të kemi investime të huaja, nëse mund t'i quajmë ato investime të huaja, u përmend këtu privatizimi i rrjetit të energjisë dhe Distribucionit. Dikush pas gjashtë muajsh duhet ta matë efektin real të këtij investimi, nëse mund ta quajmë investim të huaj, sepse Distribucioni është falur, nuk është asnjë lloj investimi nuk ka ndodhur, mirëpo nevojitet që të maten efektet reale.

Kur Qeveria t'i dijë efektet reale të investimeve të huaja dhe nëse ato dëshmojnë të jenë pozitive, atëherë institucione të ndryshme mund të angazhohen më tepër në tërheqjen e investimeve të huaja.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, është se duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe aktivizimit të kapitalit të akumuluar të diasporës. Sipas raportit të RIINVEST-it të vitit 2012, diku 20% e popullsisë totale të Kosovës është e shpërndarë dhe jeton në vendet, si: Zvicër, Gjermani, Itali dhe në kontinente tjera, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ndihma që ka dhënë diaspora para dhe pas luftës është e pakontestueshme, mirëpo është tepër shqetësues fakti që mbi 500 milionë euro remitenca në vit shkojnë komplet në konsum dhe nuk ka politika, që këto para të investohen në formë të investimeve të huaja. Andaj, ne ju bëjmë thirrje nga këtu, që Agjencia, cilado qoftë ajo për promovim të investimeve të huaja dhe Ministria e Diasporës, t'i bashkëdyjezojnë veprimet e veta dhe të shohin se si këtë kapital dhe ekspertizë të bashkatdhetarëve tanë mund ta aktivizojmë në formë të investimeve të huaja në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Obligimi i këtij projektligji se Kosova do t'u ofrojë trajtim të drejtë dhe të barabartë të investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në Kosovë është edhe një ftesë serioze që institucionet e vendit tonë po u bëjnë atyre, që të jenë më të relaksuar kur të marrin vendime për të investuar në vendin tonë dhe të zhvishen nga frika, se kapitali i tyre mund të rrezikohet që të humbë për shkak të fajit të shtetit tonë të ri.

Përveç këtij faktori, Kosova ofron edhe garanci të tjera për ta, ndër të cilat ne mund t'i përmendim disa:

- Ndërtimi në proces i një sistemi të ekonomisë së lirë dhe konkurruese;
- Zhvillimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe i demokracisë;
- Ligjet dhe harmonizimi i tyre me ato të Bashkimit Evropian;
- Investimet në kapital njerëzor dhe në infrastrukturë;
- Mbështetjen e vazhdueshme nga miqtë tanë ndërkombëtarë dhe donatorët;
- Stabilitetin politik, të cilin po e kultivojnë të gjitha partitë politike;
- Zgjidhjen ekskluzive ligjore me të drejtat për të gjitha minoritetet që jetojnë në Kosovë dhe respektimi i tyre;
- Marrëveshja me Serbinë, armikun shekullor të Kosovës, për zgjidhjen e problemeve dhe ndërtimin e paqes;
- Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian;
- Resurset e pasura të natyrës shumë minerale, burime të shumta e të llojllojshme për prodhim të energjisë, e cila është kërkesë e vazhdueshme e tregut botëror;
- Kushtet e shkëlqyeshme klimatike të vendit tonë me diferencim të katër stinëve të vitit, madje edhe me mikroklimë, të cilat mundësojnë diversitet në prodhimtarinë bujqësore;
- Fuqinë e lirë e të re punëtore dhe deri diku të kualifikuar, me potencial të madh për t'u trajnuar me sukses, me përdorues të shumtë të gjuhëve të huaja;
- Punëkërkuar me përvoja të mëdha të brezave, të trajnuar nëpër punë të ndryshme në tregjet e punës nëpër vendet e Bashkimit Evropian;
- Procedura të thjeshtësuara për licencimin dhe dhënie të lejeve të punës, (duhet t'ua kujtojmë se numri total i licencave dhe lejeve është zvogëluar me ligj).

Po ashtu, ne para disa muajsh e kemi aktivizuar edhe parimin: "heshtja është pranim", edhe këtë punë e kemi bërë me ligj për ta thjeshtësuar procedurën.

Ndër dobësitë që po na ndjekin për përmirësimin e ambientit për investime kapitale e të kapitalit të huaj, duhet t'i përmendim: shkallën e rrezikshmërisë së investimeve të huaja në Kosovë, sipas institucioneve këshillëdhënëse profesionale të bizneseve, ende po evidentohet si e lartë dhe vendi ynë ka mbetur si një ndër vendet me shkallë të lartë të rrezikshmërisë ose të riskut të investimeve.

Edhe raportet e Komisionit Evropian për shkallën e lartë të korrupsionit, të krimit të organizuar, janë deri diku negative. Ekzistimi i ekonomisë joformale, e cila ç'është e vërteta ka trend të përmirësimit, është evidente.

Mosliberalizimi i vizave për Kosovën nga Bashkimi Evropian, që po i diskriminon qytetarët e Kosovës si është më keq, duke mos i lejuar ata që t'i qasen përvojave të reja të punës e dijes në vendet e Bashkimit Evropian. Këtë diskriminim asnjë popull evropian nuk e ka. Kosova ka mbetur e mbyllur në geto dhe e kërcënuar që ta përballojë varfërinë, duke u ushqyer nga ekstremizma të llojeve të ndryshme.

Perspektiva e zhvillimit të saj është e shtyrë për një kohë tjetër e popullit tonë i është ofruar një pasiguri për të ardhmen, e cila po përcillet me raporte negative të përshkrimit, me rekomandime parimore për progres, pa i emëruar sot, domethënë protagonistët e kësaj gjendjeje.

Kosova ende ka nevojë që të punojë për përmirësimin e sundimit të ligjit, për përmirësimin e sistemit të së drejtës, për garantimin e të drejtave pronësore, për përmirësimin e politikave buxhetore, duke caktuar prioritete. Pra, duhet të bëjë reformë strukturore, të shpejtojë me privatizimin e pronës shoqërore me standarde të reja, me harmonizimin e kornizës ligjore me pakon e ligjeve të Bashkimit Evropian e mbi të gjitha me zbatimin e ligjit dhe thellimin e luftës së filluar kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat janë bërë kancer për shoqërinë e Kosovës e të cilat po nuk i luftoi ky shtet i ri, atëherë do të na çojnë drejt falimentimit.

Dëshiroj që ta inkurajoj Komisionin Funkcional që të merret me përmirësimin edhe të disa gjërave të tjera: t'i heq disa “margaritarë” në pjesën e përkufizimit, siç është rasti me nenin 2, te jepet sqarimi i kuptimit të shprehjes “të përcaktuar me ligj” ta marrim e shpjegojmë Kosovën, neni 1 pika 11 thotë, që “Kosova do të thotë Republikë e Kosovës dhe të gjitha autoritetet publike në Kosovë”, që është një lloj përkufizimi jo shumë i saktë. Një gjë të tillë e kemi të definuar në Kushtetutë dhe nuk është mirë të merremi më këtë çështje, t'i sqarojmë në mënyrë jo shumë profesionale.

Pastaj, për përkufizimin si “autoritet publik”, “fitim”, “shoqëri tregtare e Kosovës”, “aktivitet afarist”, “akti i eksproprijimit” e të tjera, janë të panevojshme sqarimet këtu, sepse nuk e përfshijnë plotësisht kuptimin e tyre dhe e lënë sqarimin joprofesional dhe jolëndor. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ky projektligj po vjen për të tretën herë. Mund të thuhet që ka pësuar pak ndryshime, por problemet elementare të cilat i kemi diskutuar në dy variantet e projektit të mëhershëm, kanë mbetur edhe me këtë. Teksti e ka pak a shumë një gjuhë jo shumë precize, që mund të dalin probleme në zbatimin e tij, por ky nuk është problemi themelor.

Problemi themelor është se gjuha e ligjit, teksti i ligjit në të vërtetë flet për problemet që i kemi ne këtu, flet për një problem zbatimin e ligjit në Kosovë, për institucione indolente në përgjithësi, por porosia e tij është: “Hajde se ne për investitorët e jashtëm po bëjmë diçka të veçantë edhe do t'ju kompensojmë kur t' u bëhen dëmet.”.

Mendoj se ky është një problem shumë serioz, sepse në çfarëdo që ne mund të bëjmë këtu, nuk mund të sjellim investitorë të jashtëm, përderisa ne nuk i zbatojmë të gjitha ligjet, nuk kemi zbatim të ligjit. Fatkeqësisht, problemi qëndron që investitorët s'po vijnë këtu hiç e të presin që ne t'ua kompensojmë dëmin. Kemi shembuj të shumtë që investitorët i qojnë duart dhe kthehen, disa kthehen prej aeroportit, disa kthehen pasi të harxhojnë një vit kohë, e nxjerrin dokumentet, i nxjerrin të gjitha lejet dhe licencat me mund të madh për dy vjet, e di një rast sepse ai rastësisht derisa kam punuar në vendin e mëparshëm të punës, e ka pas bërë një studim te ne, një investitor prej Turqie, ka ardhur për të investuar në një fabrikë të tjegullave, është nga Izmiri është investitori. Dhjetë milionë investime - zëvendësim i importit të tërësishëm dhe ai import vjen prej Serbie, ai ka hequr dy vjet për t'i rregulluar të gjitha, i ka paguar të gjitha licencat, të gjitha lejet dhe kur ka filluar të punojë, ai është përzënë gjoja prej banorëve të pakënaqur, mandej kushtëzimet e tillëve dhe thirrjet në telefon vazhdojnë.

Ky është problemi numër një i Kosovës dhe, fatkeqësisht këtij investitori askush s'i ka dalë deri sot në mbrojtje. Dhe, natyrisht që ka ardhur për të kërkuar ndihmë edhe te unë si deputet, por unë i kam thënë që unë fatkeqësisht, meqenëse unë e njoh atë projekt mirë dhe ia kam bërë studimin, kam punuar në atë studim dhe ka qenë projekt i shkëlqyeshëm, por ndoshta problemi qëndron pse ai e zëvendëson importin.

Tash, unë po mendoj, ku është problemi aty? Problemi është që e ndot ambientin, po nuk e ndot ambientin, se Agjencia përkatëse edhe e minierave edhe Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit i kanë dhënë leje, i kanë thënë: "s'e ndot". Por, domethënë dikush në mënyrë arbitrare thotë që po e shkel ligjin ose po e ndot ambientin.

Andaj, këto janë problemet reale, që duhet t'i shohë shoqëria jonë edhe duhet zbatuar ligjin, të mos luajë si macja me miun këtu, se investitorët e huaj nuk kanë qejf ashtu, ata kanë qejf të jenë të barabartë. Ata kanë qejf të jenë këtu të barabartë.

Çështja tjetër, ka të bëjë me atë, shembulli i asaj që thashë është neni 5 pika 2 thotë: "Në qoftë se organizata ndonjë autoritet i Kosovës", ruana Zot, nxjerr diçka që është jashtë autorizimeve të tij" Qysh mund ne në ligj të parashohim që dikush (ndonjë ministër, a dikush) të bëjë jashtë ligjit! Po, ajo domethënë dihen ato punë. Ne po u kallëzojmë që do të kesh këso problemesh, ende pa ardhur. Ata të huaj, që i kanë shkruar këtu domethënë, i njohin mirë, se tekstin si duket e kanë shkruar, po shihet se teksti shqip është shumë i dobët, por ata të huaj që e kanë shkruar, ata domethënë e dinë, që domethënë, autoritetet tona zakonisht i shkelin ligjet. Por, tash po donë t' i thonë investitorit të huaj, "po, po ne i shkelim ligjet, por ty do ta kompensojmë mbasi ta shkelim ligjin, prit, se t'i kompensojmë gjërat". Këto është, domethënë me të vërtetë, që e shpreh situatën tonë të mjerueshme.

Mos të flas më tutje, kisha sugjeruar që të këqyren këto gjëra krejt, të korrigjohet ligji më mirë e të bihet një ligj, që me të vërtetë i ka hije Kosovës edhe neve, sepse është e vërtetë që kemi nevojë ta rregullojmë këtë situatë.

Është një nen, që e kemi, neni 25 “Agjencia”- po bëhen prej agjenci a sa janë një agjencie që ne s’e dimë këtu thotë “rregullohet me akt të brendshëm” thuhet që s’ka efekte e në tjetrën anë e kemi prej Ministrisë që s’ka efekte buxhetore, po duhet të ketë efekte buxhetore, ose zvogëlohen shpenzimet ose rriten, kur të bëhet prej një agjencie. Edhe thotë: “caktohet me një akt të brendshëm kjo”. Në qoftë se, caktohet me një akt të brendshëm, pse e shtinë ne këtu, ne s’kemi më çka ta shtimë! Në qoftë se ne duhet të formojmë Agjenci, ne duhet të kemi një elaborat, se përse po i bashkojmë ato agjenci, pse po e formojmë në agjenci, në qoftë se ajo agjenci duhet të hyjë në ligj?

Domethënë, këto janë gjëra që unë kisha pas qejf ligjet të na vijnë më serioze, gjuha të jetë më e mirë. Problemi është ndoshta edhe me titullin e këtij ligji, ndoshta më mirë është t’i themi “investimet nga jashtë” ose “investimet e jashtme”, se “investimet e huaja”, ky është një titull pak a shumë, e di që përdoret në Shqipëri, por me këtë logjikë “foreign investment” ne edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme ishte dashur ta quajmë “Ministri të Huaj”. Domethënë, duhet t’i kemi pak, t’i shohim pak, po them ta shqyrtojmë eventualisht edhe titullin më vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e kam të njëjtën vërejtje. Një prej çështjeve që përmendi profesori, domethënë do të nisem pikërisht prej titullit të ligjit, ku thotë se duke marrë parasysh që Ligji për investimet e jashtme, domethënë është dashur të quhet “Ligji për investime të jashtme”, e jo Ligji për investime të huaja, siç po quhet.

Është një nga ato ligje, që mund t’i sjellin shumë të mira vendit, mirëpo njëkohësisht është edhe një nga ato ligje, të cilat mund të sjellin dëme fatale, të cilat mund ta rrënojnë për një natë, mund të themi kështu, sovranitetin e një shteti, andaj kujdesi në përmbajtjen e tij, në përdorimin e qartë të termeve, duhet të jetë maksimal.

Ky ligj është shumë i përgjithësuar dhe si rrjedhim ka shumë paqartësi, të cilat lënë hapësirë për interpretime sipas qejfit. Ky ligj do të duhej të hartohej mbi bazën e politikave dhe strategjisë zhvillimore të një vendi, por fatkeqësisht Kosova nuk e ka ende një strategji të tillë, e as një politikë të definuar zhvillimore.

Prandaj, ky është i vetmi ligj në botë që nuk mbështetet askund dhe në asgjë. Disa definime dhe dispozita janë të pamjaftueshme dhe në kundërshtim me njëra-tjetrën. Për shembull, neni 1, përdorimi i fjalës “rregullon, implikon vendosjen e formave të lejes së kontrollit”, para se të sigurohet korniza përbrenda së cilës investitori mund të punojë, bashkë me garancitë, të cilat i kërkon ai.

Disa fusha të ndjeshme në aspektin juridik, siç janë informimi publik, mbrojtja, zgjidhja e kontesteve, tatimet e tjera, janë definuar në mënyrë jopërkatese, të paqartë dhe të pasqaruar plotësisht. Ligji duhet të jetë më i sintetizuar dhe më i detajuar për secilën çështje. Të caktohen afatet dhe sanksionet për ata që nuk i respektojnë afatet. Të definohen qartë termat.

Çështja e kontesteve të zgjidhet në mënyrë të vazhdueshme. Një çështje tjetër e rëndësishme sa u përket investimeve të jashtme ka të bëjë me atë që investimet e jashtme duhet të bëhen në ata sektorë, të cilët nuk u bëjnë konkurrencë prodhimeve vendore.

Nëse investimet e jashtme i orientojmë në sektorët që janë të pazhvilluar, atëherë aty do të gjenerojmë punësim. Është e qartë se në vitet e para investitori gjeneron punësim dhe fiton ekspertizë, më vonë vjen profiti dhe investitori, qoftë i jashtëm, apo vendor, është i obliguar që të riinvestojë në Kosovë.

Është e rëndësishme që Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ta sjellë si politikë të re përgjegjësinë sociale për çdo biznes vendor, apo të jashtëm. Çdo biznes duhet të obligohet që një pjesë të profitit ta investojë në sektorin social, për shembull në projektet e edukimit, të shëndetësisë e projekte të tjera sociale. Në përgjithësi, ligjet që trajtojnë marrëdhëniet e Kosovës me jashtë duhet të kenë mekanizma të veçantë për mbrojtje për shkak të mungesës së mekanizmave mbrojtës, që tani për tani Kosova nuk i ka. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është kjo hera e tretë që po e shqyrtojmë një projektligj kaq të rëndësishëm si ky për investimet e huaja. Që në fillim dua të theksoj se mungesa e këtij ligji pa dyshim se ka reflektuar negativisht në ambientin e përgjithshëm ekonomik të vendit, e posaçërisht kur janë në pyetje raportet me investitorët e huaj.

Që në fillim dua ta shfaq mospajtimin tim në deklaratat e disa zyrtarëve nga Qeveria, të cilët fajin për këtë zvarritje ia hedhin deputetëve, përkatësisht Kuvendit të Kosovës, por kjo zvarritje ka ndodhur për faktin se Qeveria në Kuvend e ka sjellë një ligj jo komplet dhe që nuk i plotëson kriteret elementare. Madje ai me lëshimet e tilla, më shumë do të sillte dëme se sa të mira.

Së pari, ky version që në fillim, përkatësisht te përkufizimet, pika 1.3.2 hap mundësinë që edhe pjesëtarët nga diaspora kosovare në botë të trajtohen si investitorë të huaj, përkatësisht e shfrytëzojnë mbrojtjen dhe sigurinë që ua ofron ky ligj.

E dyta, ulja e pragut të pjesëmarrjes së kapitalit të huaj në një investim nga 25% sa ishte në versionin e mëparshëm, në 10% tash, ndihmon afaristët vendorë për krijimin e partneritetit me investitorët nga jashtë.

Neni 5, pika 2, ka pak konfuzion. Së pari, sepse ai parasheh mundësitë që ndonjë zyrtar, i cilitdo institucion publik, të nxjerrë akte jashtë autorizimeve. Nëse me të dëmtohet investitori, ai e ka të drejtën për kompensim, e nëse ai në ndonjë formë ka qenë i informuar se akti i tillë nuk ka qenë i autorizuar, atëherë nuk kanë të drejtë për kompensim. Dilema ime qëndron në faktin se pse të paragjykohet kjo mundësi, dhe e

dyta nuk duket shumë e qartë se si mund të jetë i informuar investitori për një punë të paautorizuar që e bën ndonjë zyrtar.

Neni 8, te kompensimi, është krejt në rregull, mënyra e kompensimit, e pagesës, e përlogaritjes së kamatës në rast të vonesave, por nuk thuhet në mënyrë të qartë se kush do ta bëjë vlerësimin për kompensim. Në këtë rast nuk mjafton të thuhet se kompensimi do të bëhet sipas vlerës së tregut, meqenëse nuk kemi të bëjmë me një treg stabil dhe të qëndrueshëm.

Ndryshimi më cilësor në këtë version të ligjit vërehet në nenin 11, që ka të bëjë me konfliktin e armatosur dhe trazirat qytetare, të paraqitura në krahasim me versionet e mëhershme, qëndron në faktin se këtu barazohet investitori i huaj me atë vendor. Ky ndryshim ka qenë i mirë për arsye që mbrohen edhe investitorët vendorë. Në fakt, ky është versioni i cili nuk bënte dallime ndërmjet investitorëve dhe krijimin e barabarësisë ndërmjet tyre. Ofron më shumë mundësi për partneritet.

Një vërejtje tjetër, e cila del ndoshta edhe nga paqartësia e nenit 22, është ajo për krijimin e agjencisë për investime dhe për përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë. Në këtë nen nuk është thënë në mënyrë të qartë se cilat janë kompetencat dhe përgjegjësitë që ka ajo, veçanërisht kur kemi të bëjmë me fuqitë ekzistuese të saj. Si do ta ushtrojë këtë kompetencë, meqenëse në këtë nen nuk thuhet asgjë më shumë se kjo: “Është përgjegjësi për mbrojtjen dhe për promovimin e investimeve të huaja, mbështet zbatimin e politikave dhe programet publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme dhe zhvillon politika lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike”.

Po ashtu nuk thuhet në mënyrë të saktë se çfarë profili duhet të jetë stafi i kësaj agjencie, posaçërisht kur është fjala për stafin menaxhues të saj. Pastaj, duhet të bëhet një rivlerësim i këtij neni, në mënyrë që të mos ketë përzierje të kompetencave ndërmjet agjencive që veprojnë në kuadër të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë, posaçërisht kur kemi parasysh se kjo agjenci ka kompetencë për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme, apo për themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike, përgjegjësi që e kanë edhe agjencitë ekzistuese.

Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë mangësi të madhe, por po frikohem se mos nesër do të vijmë në një situatë që vetë këto agjenci të mos e kenë të qartë se çfarë duhet të punojmë.

Edhe një herë po e përsëris se në të ardhmen duhet t’i rishikojmë edhe ligjet e tjera që i definojnë çështjet që kanë të bëjnë me biznesin dhe investitorin vendor, në mënyrë që edhe ata ta kenë një mbrojtje më të madhe, si dhe siguri për kapitalin që e investojnë. E them këtë duke pasur parasysh se sipas këtij drafti, investitorit të huaj e gëzon një përkrahje shumë më të madhe se ai vendor, si dhe shumë më lehtë mund të zgjidhen problemet apo kontestet që mund t’i ketë. Një mundësi të tillë duhet ta ketë edhe investitori i brendshëm, meqenëse ai duhet të jetë mbështetja kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit, çështja që ndihmohet nëpërmjet investimeve të huaja. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Ky ligj, i cili është i një rëndësie të veçantë, mendoj se duhet të kalohet në lexim të parë, sepse arsyeshmëria që unë jam duke dëgjuar nga kolegët tanë, qoftë anëtarë të komisionit, ku jemi bashkë në komision, apo edhe këtu në seancë së bashku, nuk jam duke dëgjuar aq shumë vërejtje, të cilat janë për t'u kthyer ai, por jam duke dëgjuar disa vërejtje, të cilat absolutisht nuk mund të zënë vend për t'u refuzuar.

Konkluzionet që vihen se ka korrupsion dhe nuk janë disa referime, të cilat thirren në emër të agjencive të huaja, unë dua t'ua përkujtoj disa kolegëve që krejt agjencitë e huaja referohen në diçka. Referohen institucionet të cilat e penalizojnë korrupsionin, referohen në prononcimet tona publike, edhe si deputetë pa denoncuar, dhe ai deputet i cili e do vendin, ose di vërtet diçka që qëndron, është mirë të denoncojë, por jo të bëjë një konkluzion dhe të thotë në mënyrë paushalle ka korrupsion, vetëm sa për t'u dukur fans në publik dhe pa e dhënë asnjë. Ndërsa qëndrimi politik i opozitës dhe i një pjese të kolegëve të mi është shumë shqetësues. Pse? Nëse partitë politike kanë vërejtje, pse nuk e bëjnë një draftligj të vetin dhe në amendamentimet, edhe me plotësimin e ligjit, të vijnë të kompletuar në komision dhe të plotësohet.

Kjo vetvetiu tregon se ka një qëndrim refuzues, hezitues, ka një propozim jokonkret paraprakisht për ta fundosur dhe për ta demotivuar edhe investitorin e jashtëm, i cili është i interesuar të vijë të investojë në Republikën e Kosovës.

Pavarësisht këtyre hezitimeve dhe rrethanave politike dhe ekonomike në të cilat gjendet edhe rajoni, në Kosovë sot ka investime të cilat janë relevante dhe të çmuara dhe ne duhet t'i japim sa më shpejt vlerë ligjit me vërejtjet edhe me sugjerimet të cilat duhet të jenë edhe në mbrojtje të investitorëve vendorë, edhe në bashkëpunim me investitorët vendorë, edhe në bashkëpunim me investitorët ndërkombëtarë, së bashku se "Holldingu", apo forma të tjera, që ne ta rritim papunësinë në këtë krizë ekonomike, sepse i kemi favorët e mëdha edhe në shkallën e të punësuarve që ne na nevojiten shumë dhe pagat të jenë më të favorshme sesa në shtetet e Evropës dhe të Bashkimit Evropian, ku plasimi i mallrave, të cilat ata mund t'i prodhojnë, janë në interesin tonë më shumë sesa të investitorëve të jashtëm.

Prandaj, unë jam i befasuar si anëtar i komisionit me qëndrimet refuzuese që po i dëgjoj këtu, pa dashur të kontribuoj që ky ligj të pasurohet. Ne po themi që Qeveria e ka bërë një ligj të dobët. Ok-ej, por ne nuk mund t'i ikim përgjegjësisë si legjislacion, të japim vërejtje, edhe propozime, qoftë edhe nga njëshi deri në fund të ligjeve, të cilat i kemi paraparë. Ne mund t'i japim këto propozime dhe t'i aprovojmë këtu, por kjo që ne nuk kemi vullnet për ta përmirësuar. Kemi vullnet vetëm për të dhënë konkluzione paushalle dhe nuk bartin përgjegjësi publike kur thuhet: ka korrupsion. Korrupsioni duhet të denoncohet me emër e mbiemër, me vepër, me kohë me ditë. Kush ka bërë, kush ka vjedhur, kush po e përgatit terrenin për t'i bërë këto punë, por jo në mënyrë hipotetike.

Këta shpifës, këta mercenarë, të cilët janë të interesuar ta fundosin Kosovën, mendoj që edhe popullata duhet ta dijë që nuk kanë interes publik, por më shumë kanë interes personal. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për investimet e huaja përgjithësisht hartohet mbi bazën e politikave dhe strategjisë zhvillimore të një vendi. Kosova ende nuk e ka një strategji të tillë, e as ndonjë politikë të definuar zhvillimore, prandaj mund të themi se ky është ligj që nuk mbështetet realisht askund dhe në asgjë. Edhe ky ligj do ta ketë fatin e ligjeve të kopjuara, të cilat nuk gjejnë zbatim. Edhe ky ligj nuk është bazuar në situatën konkrete të vendit tonë. Ajo që do të duhej bërë është një analizë krahasuese për mundësitë e përfitimit të Kosovës nga këto investime. Kjo analizë dhe diskutimet publike do t'i duhej t'i paraprijë hartimit të ligjit dhe diskutimit të tij në Kuvend.

Ligji i këtillë, që e kemi para nesh, i shpall të huaj bashkatdhetarët tanë duke treguar se ata do të trajtohen njëjtë, sikur edhe investitorët e huaj. Ne nuk bën që t'i barazojmë të huajt edhe për shkak se ata ne nuk na trajtojnë njësoj. Në bazë të këtij projektligji që e kemi para vetes, investitorët nga Shqipëria dhe investitorët nga Serbia po ashtu janë të barabartë.

Duke qenë se kjo është tërësisht e padrejtë dhe shumë e dëmshme, mendoj se nuk do të duhej as të vinte ky projektligj para nesh, e lëre më ta votojmë, apo ta kalojmë atë.

Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron që mërgata e Kosovës e ka një potencial shumë të madh për të qenë pjesë aktive e shtetndërtimit dhe e zhvillimit të Kosovës. Në alternativën tonë të qeverisëse ne angazhohemi të krijojmë përparësi për qytetarët e Kosovës jashtë vendit, për investime në Kosovë, duke krijuar kështu, jo vetëm mundësi për zhvillim ekonomik, por edhe mbështetje konkrete për riatdhesim. Një prej lehtësimeve që ne parashohim për investuesit nga mërgata jonë është lirimi i tyre nga çfarëdo tatimi apo pagese tjetër, deri në momentin e lëshimit të produkteve të tyre në treg, ose fillimit të operimit të biznesit, si dhe lehtësira administrative e bankare.

Investimet e huaja do të duhej të orientoheshin në sektorë që janë më parë komplementarë sesa që u bëjnë konkurrencë bizneseve vendore. Duke u bazuar në analizat paraprake zhvillimore, do të ishte mirë të caktohen sektorët në të cilët investimet janë të domosdoshme, pastaj shteti do të duhej ta caktonte një përqindje të profitit që do të duhej riinvestuar. Kosova e ka një shkallë prej 10% të tatimit në fitim, që është në nivel me shumicën e shteteve në rajon. Kjo shkallë është ulur në shumicën e shteteve për t'i promovuar investimet e huaja direkte.

Në Kosovë, që nga ulja e tatimit ka rënie të investimeve, si të huaja, ashtu edhe vendore, prandaj nuk mund të thuhet se kjo ulje ka stimuluar investime. Po ashtu, nuk ka dëshmi se ulja e tatimit në profit ka sjellë riinvestim të mjeteve në hapje të vendeve të reja të punës. Sipas alternativës të qeverisjes të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tatimi në fitim do të

duhej të rivlerësohet. Kjo politikë tatimore do të përdoret nga lëvizja jonë një ditë në qeverisje për të stimuluar hapjen e vendeve të reja të punës. Nëpërmjet shkallëzimit do të ofronim lehtësime tatimore për investime që synojnë aktivitete prodhuese dhe hapje të vendeve të punës.

Çdo kompani që dëshmon riinvestimin e fitimit për hapjen e vendeve të reja të punës, sidomos në prodhim, do të lirohet nga tatimi në profit. Në alternativën qeverisëse, ne parashohim subvencionim progresiv tatimor për punëdhënësit që punësojnë punëtorë të rinj dhe ata ekzistues, sipas numrit dhe statusit të ndërmarrjes sipas kësaj shkalle. Nga një deri në dhjetë të punësuar, 1% të lirit të tatimit për çdo të punësuar; nga 11 deri në 50 të punësuar, 0,5% lirimet në tatime për çdo të punësuar; mbi 51 deri në 200 të punësuar 0,3% të lirit të tatime për çdo të punësuar, dhe mbi 200 të punësuar 0,1% të lirit të tatimit për çdo të punësuar.

Në të njëjtën kohë, përgjegjësia korporative sociale apo shoqërore mbetet një çështje shumë e rëndësishme. Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë duhet ta sjellë si politikë të re përgjegjësinë sociale për çdo biznes. Investitorët e huaj duhet të obligohen që një përqindje të caktuar ta investojnë në sektorët socialë. Për shembull, të investojnë në projektet e edukimit, shëndetësisë, mjedisit, apo në ndonjë projekt tjetër të çështjeve sociale.

Me këtë projektligj është paraparë që në rast të konfliktit të armatosur dhe trazirave qytetare, Kosova do ta trajtojë atë investitor të huaj apo person të huaj sa i përket kompensimit apo zgjidhjes tjetër, njëjtë dhe të barabartë me ndonjë investitorë vendor dhe investimeve vendore. Këtu duhet të shtrohet pyetja: çka ndodh në ato raste kur një investitor ka kontribuar në trazira, apo nuk ka qenë neutral te ato?

Te neni 2, te pjesa e përkufizimeve, thuhet që një shoqëri e huaj investuese konsiderohet ajo që së paku 10% të kapitalit të vet e ka kontribuar direkt apo indirekt. Mendoj se përqindja e caktuar është shumë e ulët.

Te neni 22, mendoj se përkufizimi i Agjencisë për Investime dhe për përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovës është shumë i shkurtër, i thatë dhe i paqartë. Do të duhej të bëhej një përkufizim më i saktë dhe më i gjerë sa u përket përgjegjësisë dhe punës. Në fund, le të mos harkojmë që 90% të investimeve të huaja direkte në botë shkojnë në vende tashmë të zhvilluara, e jo në vendet në zhvillim, apo të pazhvilluara, si puna e Kosovës.

Pra, le të mos mendojmë që zhvillimi na vjen prej jashtë. Ne e përfaqësojmë modelin e shtetit zhvillimor, ku zhvillimi vjen nga brenda dhe më pas ndihmohet prej jashtë.

E kam përshtypjen që shpëtimin, edhe në aspektin ekonomik, ne e shohim sipas shpëtimit të menduar politik, që na vjen disi prej jashtë në formën e bombave të NATO-s, veç kësaj radhe në formën e investimeve prej jashtë. Kjo nuk do të ndodhë dhe jam i bindur se e vetmja mundësi për të ecur përpara është një plan strategjik zhvillimor sipas modelit të shtetit zhvillimor, ku zhvillimi buron nga brenda dhe ndihmohet prej jashtë.

Vetëm atëherë kur ne do të jemi tashmë të zhvilluar për biznesin vendës, do të mund të kemi edhe investime të huaja. E nëse presim për investime të huaja në kushtet kur Qeveria ua vështirëson biznesin vendësve, do të presim vetëm korporata matrapaze, të cilat do ta marrin profitin të ne dhe njëkohësisht pasojat do të na i lënë neve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Atë që patëm ta themi si grup, e tha deputeti Kelmendi, mirëpo më nxiti deputeti Muja që t'i them nja dy-tri fjalë. Çështja është kështu: Pse ne nuk po e votojmë këtë ligj? Duhet ta sqarojmë. Ne jemi parti e qendrës së djathtë, e nuk mendojmë se duke mbjellë qepujka, do ta zhvillojmë ekonominë e Kosovës. Ne e dinë qartë se investimet e huaja janë më se të domosdoshme.

Por, arsyeja pse ky ligj nuk duhet votuar është për shkak se në Kosovë nuk po ndryshon kurrgjë me të.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria me këtë ligj po na e humbin kohën ne si Kuvend, po ia humbin kohën vetes, në stilin e 'Banjskos'. Asnjë gjë të re nuk po e sjellin dhe bile-bile po na sjellin elemente goxha kontradiktore. Po thonë 'tash e tutje duam ta trajtuar njëjtë Diasporën tonë si investitorët e tjerë të huaj'. Pse, si i kanë trajtuar deri tash? Njësoj i kanë trajtuar edhe deri tash. Domethënë, të mos na shesin këso demagogjie pa lidhje.

Sa për deputetin Muja, ma merr mendja se e di edhe ai vetë se është shumë-shumë-shumë gabim kur thotë se nëse dikush në Kosovë thotë se ka korrupsion, janë cinikë dhe dashakëqij. Kosova është e zhytur në korrupsion deri në maje të hundës, Shaip, dhe mezi po merr frymë. E di që këtë e di edhe ti. Nuk janë as dashakëqij, as cinikë ata që thonë që në Kosovë ka korrupsion marramendës. Faleminderit!

KRYETARI: Shaipi tha diçka tjetër. Hykmetja, replikë. Hykmete, e ke pasur fjalën. Deputete Hykmete, ta dhashë fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Replikë kam, kryetar!

Faleminderit, kryetar!

Edhe unë po i përgjigjem deputetit Muja se ka deputetë këtu që fjalimet e veta nuk i shkruajnë, duke u inspiruar duke pirë çaj rusi, por lexojnë raporte të ndryshme, ligje dhe bëjnë analiza. Nuk jam as mercenare, as shpifëse dhe nuk e besoj që është askush nga grupi ynë mercenar dhe shpifës. Unë kur thashë që ka korrupsion, pikërisht për të mos shpifës dhe mercenar, iu referova tri raporteve. Thashë e ke në raportin e Transparency International, që e rendit Kosovën te vendi 112, nga 183 vende për korrupsion.

E ke në raportin e fizibilitetit të Komisionit Evropian, në faqen 15, ku thuhet: Kosova ka shumë ekonomi informale dhe korrupsion, që pothuajse që të dyja janë të njëjta, dhe NDP-ja gjithashtu e ka vërtetuar të njëjtën gjë në raportin e paralajmërimit të hershëm të vitit 2013. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, dy minuta i ke!

SHAIP MUJA: Unë i kam 4 minuta, por po befasohem me qasjen që janë duke e bërë kolegët tanë nga opozita. Kur unë thashë një parti politike që pretendon të jetë serioze, e përgatit ligjin vet dhe e sjell në komision. I ka anëtarët e vet dhe thotë: “Ky është ligji”. Edhe nuk sjellin asgjë, vetëm thonë ‘do të refuzojmë’. Dhe, mënyra si partitë politike paraqiten ‘jemi të djathtë’, e veprojnë majtas, kjo e tregon kaosin shoqëror të të menduarit shoqëror.

Prandaj, mënyra siç thashë unë, nëse ka korrupsion, të gjitha agjencitë të cilat raportojnë, referohen në diçka dhe thonë ‘poshtë’. Meqë zonja nuk pi, por diçka tjetër, unë i referoj të shoh në fusnota poshtë kujt i referohen ata. Thonë: Në diskutimin publik të Parlamentit. Nga ky diskutim e kam marrë, sepse ata mendojnë se ka deputetë të përgjegjshëm nga votat që kanë ardhur aty dhe mbajnë përgjegjësi publike dhe shtetërore pse flasin. Dhe flasin me fakte. Ata nuk e dinë që këta nuk flasin me fakte, por flasin paushall, vetëm sa për të thënë diçka dhe të dalin në televizor. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, replikë!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Mendoj se parafolësi e ka huq krejt temën dhe nuk është objektiv i partisë politike të sjellë ligje këtu. Është i Qeverisë që t’i sjellë ligjet dhe po shihet çfarë i sjell, prandaj të mos i ndërrojmë gjërat dhe të tentojmë tash ta hedhim fajin diku tjetër, se bërjen e ligjeve e ka për obligim Qeveria, përpos do punëve tjera, me të cilat merren, e që e di e gjithë dynjaja, nëse mund të thuhet - atë që e thanë kolegët tanë, që merren me punët, të cilat dihet kush duhet t’i bëjë ato. Janë organet e drejtësisë dhe sigurisht ka hapësirë për këtë punë. Por, edhe unë pajtohem që këtë duhet lënë organeve të drejtësisë. Ndërkaq sa i përket djathtëzimit dhe Shaipit, Zoti na ruajt!

KRYETARI: Shaip, vetëm një minutë!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar!

Unë nuk mund t’ia qetësoj situatën në Vranjevc zotit Beqiri, që e ka rrokur kriza, dhe nuk e kupton procedurën çfarë fola. Ky i ka tre deputetë të Partisë së Lidhjes Demokratike, po ashtu ka edhe AAK-ja në Komisionin për Zhvillim Ekonomik. Dhe, partia, nëse është serioze, e përgatit nëpërmjet deputetëve të vet dhe e sjell propozimin në komision. Prandaj, unë jam i shqetësuar që ky thotë ‘unë kam eksperiencë’, ‘jam i djathtë’, e nuk është as i majtë e as i djathtë, se po të kishte qenë i majtë ose i djathtë e kishim kuptuar. Por, është i padefinuar, prandaj ky kaos tregon edhe kaos në të menduarit shoqëror. Dhe për ata do të humbë edhe Vranjevci. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Me të vërtetë është për t’u dhimbsur qytetarët e Kosovës, por këtij nuk do tëi bjerë në mend për Vranjevc çfarë do t’i bëjmë në pjesët tjera të Kosovës. Ky e di atë punë, kështu

që nuk e vlen. Flasin votat. Ky, si duket, e ka ngatërruar sot. Ky nuk është vendi për të bërë fushatë. Duhet të jemi më seriozë, por mendoj se kemi folur për ligje, e jo për lagje të caktuara. Unë po them - shihemi më 4 nëntor.

KRYETARI: Faleminderit! Ardian Gjini, replikë!

ARDIAN GJINI: Faleminderit kryetar!

Shumë shkurt, dy ose tri fjali. Të thuhet që dikush është i djathtë, e të jetë krejt i majtë, ma merr mendja se publiku i Kosovës e ka tepër të qartë, se kush është Partia Demokratike e Kosovës. Thonë jemi të djathtë, faktikisht jemi krejt majtas. Nuk ka asgjë të keqe të jenë majtas, por le të tregojnë.

Çështja tjetër është te puna e sjelljes të ligjeve. Nëse isha i qartë, arsyeja kryesore pse nuk ka nevojë për këtë ligj hiç se ligjet janë, por nuk ka Qeveri e cila i zbaton ato ligje. Dhe, ne do të kishim mund ta sjellim një ligj, por do ta sjellim kur të vijmë në pushtet, Shaip, kur t'i fitojmë zgjedhjet. T'ua sjellim këtu një ligj të mirë, prapë në krye të gjashtë muajve kërkojnë të ndërrohet se nuk janë në tokë të bukës hiç. Faleminderit!

KRYETARI: Mjerimi ynë është që këtu nuk ka as të majtë, as të djathtë. Por, e lëmë këtë punë. Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni edhe një herë t'ju përkujtoj po ashtu që debati që ka qenë edhe më herët edhe në komision, ka qenë një debat mendoj që nuk i ka takuar kësaj situatë, atmosfere parazgjedhore. Po ashtu, duhet ta kujtojmë që fillimi i inicimit të këtij projektligji ka qenë në një kohë më të hershme, kur nuk ka qenë po ashtu atmosferë parazgjedhore. Po më vjen keq që këtu po dëgjojmë edhe programe politike, në vend se ne t'i japim udhë punës konkrete në hartimin sa më të mirë dhe kualitetin e këtij projektligji.

Duhet ta them po ashtu se iniciativa për nxjerrjen e këtij projektligji para se të vijë nga Ministria, përkatësisht Qeveria, ka lindur në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, pra një vend ku, përveç ministrive dhe Qeverisë, janë edhe disa institucione ndërkombëtare mbështetëse të vendit tonë në fushën e zhvillimit ekonomik dhe po ashtu ky projektligj, përkatësisht ky ligj që mund të vijë sa më shpejt do t'i ndihmojë vendit tonë në krijimin e një imazhi më të mirë, sidomos në prag të hapjes të negociatave të vendit tonë me BE-në.

Unë jam ithtar i asaj që ky projektligj të mos i nënshtrohet debatit elektorale tash këtu. Të punojnë partitë politike, deputetët, përkatësisht në grupe punuese, në grupin punues që ta nxjerrim një kualitet sa më të mirë. Ideja jonë e të gjithëve ka qenë që ta krijojmë në vendin tonë në klimë sa më të mirë administrative dhe shtetërore, që investimet e huaja të kenë sa më shumë përkrahje në vendin tonë.

Ne kemi edhe një varg projektligjesh dhe ligjesh tjera që i kemi aprovuar në këtë vend, që e trajtojnë fushën e zhvillimit ekonomik, edhe marrëdhëniet tona me shtetet fqinje, me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Serbinë dhe të tjera. Jemi po ashtu anëtar regional në

institucionet që i zhvillojnë këto marrëdhënie. Nuk mendoj se ky projektligj tash duhet të përzihet në gjithë këtë retorikën politike elektorale.

Po ashtu, dua t'ju kujtoj që nuk është ky projektligji i parë i ri që e kemi sjellë në këtë Kuvend. Nuk duhet të frikohemi nga iniciativat e reja, nga ligjet e reja që do të vijnë dhe duhet t'i inkurajojmë po ashtu që edhe projektligje të reja të sjellë Qeveria, edhe në këtë fushë, edhe në fushat tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi më diskutime. Shkojmë në votim. Të pranishëm janë 72 deputetë. Më falni, fjalën e ka zëvendëskryeministrja dhe ministrja Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Vetëm shkurtimisht desha një reflektim të vogël në krejt debatin, i cili u zhvillua këtu dhe çështjet të cilat u adresuan në ligj, nuk e di, ndoshta janë keqkuptuar, apo janë interpretuar ndryshe. Si e para ligji figuron në shumë raporte ndërkombëtare, se u përmendën raportet ndërkombëtare, si ligj që mungon. Domethënë u është bërë thirrje disa here institucioneve të Kosovës të definohet një ligj i ri për investimet nga jashtë, apo investimet e huaja.

Së dyti, ligji e ka synim barazimin. Në ekonominë e lirë të tregut dihet se një investim duhet të trajtohet i barabartë dhe ai investim që bëhet në Kosovë, është investim për Kosovën, për punëtorët e Kosovës, për ekonominë e Kosovës, për rritjen e GDP-së së Kosovës, pa marrë parasysh prej kah është prejardhja e kapitalit, përderisa krijohen kushtet e barabarta.

Gjithashtu u përmendën nenet kontradiktore. U tha se në ligj parashihet se autoritetet kosovare mund të nxjerrin dispozita, vendime, apo akte, që mund të mos jenë në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm. Realiteti është se në Kosovë ndodh një gjë e tillë. Realiteti është se në Kosovë ka pasur raste kur autoritetet, qoftë në nivelin lokal apo qendror, agjencitë e caktuara, nxjerrin akte apo dispozita, për të cilat është dashur ndërhyrje, të cilat e kanë cenuar ambientin e biznesit.

Unë e kuptoj se të gjithë e dëshirojmë një ambient investiv më të mirë në Kosovë. E dëshiron edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, edhe Qeveria e Kosovës, edhe ju deputetë, edhe agjencitë tjera. Por, të gjithë duhet ta dimë pjesën tonë të punës në raport me atë se çfarë mund të mbulojë një ligj. Ky ligj nuk është ligj, i cili do ta ndryshojë edhe Kodin Penal të Kosovës.

Nëse e dëshirojmë një luftë më të rreptë ndaj korrupsionit, ekzistojnë mekanizmat tjerë. Nëse dëshirojmë që t'i heqim lejet dhe licencat, ju shumë shpejt do ta keni në lexim të dytë ligjin mbi lejet dhe licencat, ligj ombrellë i cili heq 40% të lejeve dhe licencave aktuale, të cilat do ta përmirësojnë ambientin e biznesit.

Ju shumë shpejt do ta keni të amendamentuar Ligin e prokurimit publik, ligj i cili u jep përparësi prodhimeve vendore deri në 15% më të shtrenjta nëse janë dhe aplikojnë në tenderët publikë në Kosovë.

Ekziston një strategji kombëtare dhe ajo strategji kombëtare zbatohet apo prezantohet nëpërmjet Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, në të cilin keni përfaqësimin edhe të Kuvendi të Kosovës nëpërmjet Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Presidenca, USAID-i, Banka Botërore dhe të gjithë të tjerët që janë të interesuar ta shohin Kosovën si një vend më të mirë për investime.

Unë ju apeloj gjithashtu ta shikoni edhe pjesën e bashkimit të dy agjencive në kuadër të MTI-së. Thuhet se nuk ka sqarime. Ne si Qeveri gjithashtu e kemi miratuar reformën e Administratës Publike. Secila ministri, një nga një, e ka prezantuar në Qeveri ristrukturimin dhe është dokument i cili është valid dhe i cili mund të gjendet për këdo që ka dyshime apo brenga mbi ristrukturimin e Ministrisë të Tregtisë dhe të Industrisë, një proces i cili gjithashtu është shprehur si shumë pozitiv, edhe nga Komisioni Evropian, dhe siç e dini e kemi dritën e gjelbër për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Është hera e fundit, të nderuar deputetë, që ju drejtohem në pozitën e zëvendëskryeministres dhe ministres së Tregtisë dhe Industrisë në këtë legjislaturë. Prandaj, e mora fjalën duke ju thënë se fuqishëm se ky ligj do të ndikojë në përmirësimin e ambientit investiv në Kosovë, që singërisht shpresoj që sot do ta votoni dhe do ta miratoni me të gjitha ndryshimet që ju mendoni se janë të domosdoshme. Do t'i kontribuoni në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë i kemi 77 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 38 vota për, 30 kundër dhe 3 abstenime Kuvendi e miratoi ligjin në parim.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Administratës publike, Mahir Jagxhilar, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që ta prezantoj Projektligjin për Institucionin e Kosovës për Administratë Publike. Kompletimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore për rregullimin e të gjitha sferave të jetës në Republikën e Kosovës përbën, jo vetëm fokusin kryesor të angazhimit tonë, por njëherësh edhe njërën nga sfidat kryesore për institucionet e Kosovës, në këtë rast edhe për Ministrinë e Administratës Publike.

Në anën tjetër, disa ligje të aplikueshme në Kosovë nuk u përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja, si dhe standardeve të legjislacionit evropian. Kjo e shtron edhe nevojën për rregullimin e këtyre çështjeve me dispozita ligjore. Në këtë aspekt, Projektligji për Institutin e Kosovës për Administratë Publike është një dokument ligjor, i cili përmbledh rregullat procedurale që synojnë t'i garantojnë parimet e përdorimit dhe të qarkullimit të njohurive profesionale; marrjen pjesë e personave kompetentë në trajtime përkatëse, arsimimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në Shërbimin Civil dhe Administratën Publike, në pajtim me standardet evropiane.

Kjo fushë deri tash është rregulluar me rregulloren e nxjerrë nga UNMIK-u dhe tani me aprovimin e Ligjit për IKAP-in synohet që ky institut të përforcohet me një institucion kompetent për ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në Administratën Publike. Me këtë projektligj është paraparë që IKAP-it t'i mundësohet funksionimi më i mirë dhe t'i përmirësojë shërbimet që ofron për Administratën Publike në nivel qendror dhe lokal, me qëllim të aftësisë dhe profesionalizimit të nëpunësve civilë.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregullores e Punës së Qeverisë. Është hartuar në formë dhe strukturë siç parashihet edhe me udhëzimin administrativ për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit për Shërbimin Civil, gjatë hartimit të projektligjit në fjalë janë inkorporuar edhe sugjerimet nga donatorët dhe institucionet ndërkombëtare sa i përket arsimimit dhe ngritjes së kapaciteteve në institut. Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete buxhetore të parapara edhe në deklaratën financiare për koston e projektligjit.

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që ta aprovoni këtë projektligj, gjithnjë me qëllim që këto çështje të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11.9.2013, e shqyrtoi në parim Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet në parim në parim Projektligji nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

A r s y e t i m

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, vlerësoi se ai i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është për herë të dytë në Kuvend, ka pasur vërejtje herën e kaluar në leximin e dytë të tij. Po ashtu, edhe gjatë shqyrtimit në komision, para leximit në parim, deputetët kanë pasur vërejtjet e tyre, sidomos ka qenë i diskutueshëm neni 12 i Projektligjit, por me shumicë votash kemi rekomanduar që projektligji të vijë për lexim të parë, e pastaj në fazën e amendamentimit të shohim dhe projektligji të plotësohet, të ndryshohet dhe të jetë i aplikueshëm, prandaj i lus deputetët që projektligjin ta përkrahin në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryetari i Komisionit e theksoi që ne sot pra për herë të dytë po e shqyrtojmë në parim edhe një herë Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Më lejoni ta falënderoj ministrin për përgjegjësinë dhe për mënyrën që e gjeti që t'i koordinojë vërejtjet tona si deputetë dhe të vijë sot me një formulim të ri në nenin, në të cilin kishte vërejtje.

Më lejoni të them se ne sot e kemi shumë të rëndësishme që ta miratojmë në parim Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, posaçërisht në këtë fazë kur edhe vetë të gjithë këtu kemi dhënë shumë vërejtjeje në raportin e fundit për zbatimin e Ligjit të Shërbimit Civil, por edhe te çështjet e zhvillimit të Administratës, në përgjithësi.

Nëse ne sot do të votojmë dhe besoj se duhet ta votojmë në parim këtë projektligj, ne do t'i mundësojmë Institutit të Kosovës për Administratë Publike një zhvillim më të hovshëm. Realisht, do të kemi mundësi që nëpërmjet fuqizimit të tij, me një ligj, për herë të parë, ta shfuqizojmë mënyrën e funksionimit të tij me udhëzime administrative dhe, e

dyta, nëpërmjet fuqizimit me këtë projektligj, ne do t'i mundësojmë Institutit të Kosovës për Administratë Publike të fuqizojë programe të reja.

Çka janë këto programe të reja? Konkretisht, me projektligjin e ri do të mundësojmë që programet e reja t'i zhvillojnë kapacitetet e drejtuesve të lartë në Shërbimin Civil, posaçërisht e atyre institucioneve, të cilat deri tani nuk ishin nën kompetencë, por nën mbikëqyrje ndërkombëtare. Pra, konsideroj që edhe ky është një aspekt shumë i rëndësishëm që ne të ndihmojmë me miratimin e projektligjit në fjalë.

Bartja e kompetencave dhe obligimet e reja për shërbyesit tanë civilë, posaçërisht niveli i lartë drejtues, kanë nevojë për aftësime shtesë dhe këto aftësime kanë mundësi të ofrohen me kurrikulat e reja, por edhe trajnerë të aftë edhe nëpërmjet programeve të trajnimit që mund të zhvillohen në Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Ky ligj e rregullon këtë fushë shumë mirë dhe me përgjegjësi, meqë në dispozitat e tij krijohet baza për përmirësim të këtyre shërbimeve që kanë qenë deri tani.

Ky projektligj që e kemi sot në diskutim e krijon këtë mundësi shtesë edhe me fuqizimin e ri financiar për IKAP-in, duke ofruar pra trajnime me pagesë për kategori të reja nëpunësish, por edhe për persona fizikë dhe juridikë, normalisht në përputhje me ligjet në fuqi për menaxhimin e financave publike. Ky projektligj e bën IKAP-in edhe më konkurrues në tregun e trajnimeve, kur dihet se kompanitë e ndryshme private u ofrohen institucioneve tona me shërbime trajnimesh dhe në këtë drejtim dublifikohen këto shërbime.

Po ashtu, sfidohet edhe puna e këtij institucioni, në të cilin është investuar me dekada edhe nga institucionet dhe shtetet tona mike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në seancën që e khyem projektligjin, ne e vumë në dilemë vetëm nenin i cili parashihte që IKAP-i në një fazë të zhvillimit ta ketë edhe një rol shtesë. Besoj se riformulimi i këtij neni sot vjen me vizion më të qartë. Pra, me nenin e ri, në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, IKAP-i do të ketë mundësi të organizojë programe të arsimit në fushën e Administratës Publike. Pra nuk është neni në theksin që parasheh që brenda 5 vjetëve të shndërrohet në një institucion arsimor, mirëpo të krijojë dhe të ndërtojë programe të arsimit në fushë të veçantë, në fushën e Administratës Publike.

Dhe, në këtë drejtim ministri i ka marrë parasysh vërejtjet tona dhe e ka ndryshuar këtë formulim. IKAP-i, edhe në nenin 2, te fushëveprimi i tij, i përcakton përgjegjësitë, pra si përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit dhe zhvillimit të kapaciteteve në Shërbimin Civil.

Është shumë mirë e theksuar se programet e arsimit në IKAP do të zhvillohen vetëm pas ngritjes së kapaciteteve dhe pas akreditimit të IKAP-it, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Pra, vizioni është i qartë dhe të gjitha institucionet e këtij lloji në rajon dhe më gjerë, në fazën e zhvillimit të tyre, në fushën kryesore të programit trajnues të tyre, pra për

Administratë Publike, mund t'i rritin përgjegjësitë. Konkretisht, arsimimi për shërbyesit e karrierës, të cilët mund të marrin role drejtuese në administratë, të kenë mundësi që këtë ta bëjnë nëpërmjet Institutit të Kosovës për Administratë Publike.

Unë shpresoj që të gjithë ne bashkë ta kuptojmë dhe të besojmë qartë në vizionin që ka ky institucion. Ne në miratimin në parim, i japim mundësi t'i shohim në të ardhmen produktet pozitive për gjeneratat e ardhshme të nëpunësve tanë civilë. Me miratimin e këtij ligji hapim rrugë dhe krijojmë mundësi shtesë, pra mundësi reale për ngritje dhe për zhvillim edhe më profesional të shërbyesve tanë civil. E krijojmë bazën ligjore për zhvillimin e Administratës Publike të vendit tonë të ri.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim dhe i ftoj edhe kolegët e tjerë që ta mbështetin dhe t'i japim një shans. Faleminderit.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra kolegë,

Edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së është diskutuar ky Projektligj dhe, duke marrë parasysh se kjo është hera e dytë që projektligji është dorëzuar, është proceduar, ne po e krijojmë një besim se e kemi një qasje të drejtë dhe se do të mund ta përmirësojmë atë që për momentin konsiderojmë se nuk është mirë e definuar.

I mbështes të gjitha ato ide që flasin për rëndësinë e Institutit, si dhe për misionin që e ka ai. Bile unë dua të shpreh keqardhjen time që 4-5 vjetët e fundit Instituti është lënë pas dore dhe, për fat të keq, me miliona mjete nga donatorët janë shfrytëzuar jashtë tij në ngritje të kapaciteteve. Pikërisht aty ku është prioriteti i misionit të këtij Instituti, pra ngritja e kapaciteteve dhe aftësimi dhe tani kur është momenti që të fuqizohet, sikur krijohet një përshtypje që prapë nuk është prioritet kryesor i Institutit të merret me pjesën e aftësimit, pra dhe të dhënies së certifikatave. Por, herën e kaluar më shumë ka qenë poenta tek arsimimi. Pra, një duplikim i institucioneve arsimore, që ka qenë i papranueshëm.

Ne tani përsëri e kemi procedimin e ligjit dhe ashtu siç u tha në mënyrë shumë korrekte nga kryetari i komisionit, ka qenë një pajtueshmëri gati thujse e plotë që të mos e rikthejmë ligjin prapë, që në raport me nenin 2 dhe nenin 12, ku flitet për kompetencat e Institutit për arsimim, nuk ka nevojë dhe duhet të shkojë, sepse atëherë kemi krejt një diçka tjetër. Na shndërrohet një fakultet dhe sikur secili ministër të kërkojë fakultete në kuadër të institucioneve që i përgjigjen atij, atëherë ku na çon kjo punë.

Prandaj, ne sot po ia japim mbështetjen me besimin e plotë se ndërmjet dy leximeve, fjala "arsimim" do të fshihet edhe nga neni 2, edhe nga neni 12, ose shoqëria kosovare duhet pra të rikthehet dhe secilës ministri t'ia formojë nga një fakultet për të dhënë diploma, gjë që s'do kishte kuptim.

Jemi në mbështetje të Institutit, për fuqizimin e institutit, jemi për atë që Instituti ta ketë misionin kryesor - aftësim dhe certifikim.

Lejohet në formulime, në kuadër të ligjit, që Instituti të krijojë bashkëpunime me institucionet arsimore, në mënyrë që t'i shërbejë arsimimit të rinjve tanë, por jo që vetë të jetë bartësi themelor i arsimimit.

Prandaj, për sot po e themi, si një kredi, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta mbështesë në parim këtë ligj, mirëpo ndërmjet dy leximeve ne insistojmë që fjala “arsimim” të fshihet nga neni 2 dhe nga neni 12, ose përndryshe nuk do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo situatë është pak specifike, prandaj duhet reagim i menjëhershëm.

Zotëriu që foli në emër të grupit, nuk e paraqiti qëndrimin e grupit, ai bëri variacion të vetin.

Grupi Parlamentar i LDK-së, që edhe herën tjetër e ka diskutuar në seancë në imtësi dhe ka refuzuar këtë ligj, i cili vjen të njëjtën formë substancialisht me makijazh të vogël të përmirësimit, është thënë që nuk përkrahet. Dhe, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e përkrah. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Parimisht, ideja që të krijohen institute brenda ministrive të caktuara është një fenomen thuajse që ndodh në shumë vende të botës. Pra, ministri të caktuara krijojnë institute brenda tyre, në mënyrë që ato institute të informojnë dhe të përgatisin të dhëna e statistika mbi trendet globale që ndodhin. Ndodh që ministri të caktuara t'i kenë edhe pesë institute brenda vetes, të cilat kryejnë studime mbi trendet globale dhe i informojnë ministrinë për ato, në mënyrë që ato ministri më pastaj ta marrin vendimin politik në përputhje me ato të dhëna statistikore dhe shkencore, çfarë u afrohen.

Por, situata është ndryshe për shkak se rekrutimi i njerëzve nëpër ato institute bëhet pasi ata njerëz të jenë të trajnuar, të jenë të aftësuar shumë mirë në nivele të larta akademike dhe atë dije të tyre akademike inkuadrohen që ta artikulojnë nëpër nevoja të ministrisë.

Ndërsa këtu e kemi një situatë krejt tjetër, sepse ky institut ka për qëllim që ta përmirësojë në njëfarë mënyre administratën publike. Kështu janë motivet e tij të shprehura në projektligj.

Dhe, ideja dhe motivet që Administrata Publike të jetë më e mirë është ide parimore. Askush nuk e kundërshton këtë, por shtrohet pyetja se si do të bëhet dhe si do të realizohet ky qëllim?

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” për këtë arsye ka dilema të mëdha lidhur me këtë projektligj, pikërisht për shkak të strukturës së tij të neneve që përmbajnë, e veçanërisht të pjesës problematike të neneve 11 dhe 12.

Bie fjala, te neni 11 thuhet që, “për nevojat e zbatimit të programeve të aftësimit, në cilësinë e trajnerëve, IKAP angazhon nëpunës civilë”. Tash vijmë në situatën, që ky ka për synim të aftësojë nëpunës civilë dhe tash angazhon nëpunës civilë, si dhe ekspertë e profesionistë të tjerë.

Por, kur kalojmë te neni 12, aty flitet për programe të arsimimit. Pra, shtrohet pyetje cilët janë ata persona, çfarë është shkalla e gradimit të tyre akademik, të cilët duhet ta realizojnë një program të tillë, sepse dihet, është e përcaktuar me ligj, është e përcaktuar me norma juridike cilët persona kanë të drejtë të japin programe të arsimimit.

Dhe, nëse është puna vetëm për çështje të trajnimit, atëherë ajo është çështje tjetër. Por, nëse është fjala për programe të arsimimit, arsimimi është një çështje tjetër dhe mendoj se pikërisht ky konfuzion, pikërisht këto dilema, se a është ky institucion me motive të arsimimit, apo të trajnimit të stafit administrativ, na vendos para një situatë që nuk mund t’i japim mbështetje në këtë fazë këtij projektligji, pa u qartësuar plotësisht këto dilema strukturore dhe organizative sa i përket Institutit të Administratës Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Aleancë jemi për atë që të shqyrtohen shumë prej çështjeve, të diskutohet, pra të bëhet një debat, i cili konsideroj se nga kthimi i këtij projektligji që në herën e parë nuk ka pësuar ndryshime. I dimë arsyet pse është kthyer ky projektligj.

Edhe ne si Aleancë jemi që funksionimi dhe roli i IKAP-it duhet të rregullohet me ligj të veçantë, por jo në këtë formë.

Ndryshimet kozmetike që kanë ardhur edhe kësaj radhe janë që na bëjnë të besojmë që të mos e japim votën për.

Kur jemi te roli i këtij instituti, i këtij institucioni, ne si Aleancë vlerësojmë se ai nuk ka kapacitete as për trajnimet dhe as për t’i realizuar planet, të cilat ua dërgon komunave.

Unë flas me përgjegjësi, duke i marrë informatat edhe nga komunat, përkatësisht nga Komuna e Gjakovës, ku instituti, sikur çdo komunë tjetër, e ka dërguar planin vjetor të trajnimeve. E ka dërguar planin vjetor, dhe Komuna e ka hartuar planin e vet, duke menduar se do të bëhet trajnimi i punëtorëve të institucionit komunal.

Dhe, që nga fillimi i vitit 2013 e gjer më tani, në fund të muajit shtator, në komunën e Gjakovës janë trajnuar vetëm dy zyrtarë të Prokurimit. Pra, kjo tregon se ky institut nuk ka kapacitete as për trajnimin e punëtorëve të administratës, e lëre më të marrë përgjegjësi të cilat nuk i takojnë dhe synon shumë më larg, të shkojë edhe te çështjet arsimore, që janë në kundërshtim me Ligjin për arsimin e lartë.

Pos vërejtjeve që u treguan nga deputetët tjerë të grupeve parlamentare të tjera, fjala “arsimim” duhet tërësisht të hiqet në çdo nen dhe të dihen kapacitetet e këtij instituti.

Janë edhe shumë çështje tjera që janë dhënë, edhe vërejtje të përgjithshme lidhur me përmbajtjen, edhe nga Drejtoria për Standardizim dhe Përafrim dhe Harmonizim Ligjor, ku përmenden edhe shumë çështje tjera. Ndër të tjera është edhe çështja e buxhetit, meqë as në kornizën afatmesme buxhetore të vitit 2011-2014 nuk është ndarë asnjë mjet buxhetor për këtë projektligj.

Pra, nuk diskutohet - vota jonë është kundër dhe është mirë që të mendohet dhe kur vijnë ligjet të punohet dhe mos të vihet sa për t’u përpjekur që deputetëve t’u sillet një projektligj me disa ndryshime të vogla, por në përgjithësi ky projektligj nuk është ndryshuar dhe janë shumë çështje që preken dhe janë në kundërshtim, e thashë edhe një herë, me Ligjin e arsimit të lartë.

Pra, duhet të mendohet në këtë pozicion, jemi për ta përkrahur Institutin dhe për të bërë një ligj për të, por jo të përzihen çështjet dhe me të vërtetë të mendohet se aq shumë është kah bëhet zhurmë, të mos them biznes në arsimin në Kosovë.

Pra, ju lutem, të jemi konkretë, të punojmë për Institutin, pra për interesin dhe rolin që e ka, duke i ditur edhe kapacitetet e tij, që nuk janë kapacitete për trajnime, e lëre më për ta arsimuar edhe stafin administrativ. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Rreth këtij projektligji, Grupi ynë Parlamentar është deklaruar edhe në leximin e mëparshëm. Për këtë projektligj foli vetë ministri, folën edhe deputetë. Pajtohemi me disa propozime, mirëpo ne si Grup Parlamentar jemi për atë që ky ligj të miratohet tani në leximin e parë dhe ato vërejtje të përmirësohen në fazën tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Edhe ne i kemi parasysh vërejtjet të cilat u dhanë në këtë

projektligj, mirëpo mendojmë se ia vlen t'ia japim rastin për përmirësim dhe e kemi mundësinë ta kalojmë në parim dhe mundësinë që ndërmjet dy leximeve t'i japim rekomandimet tona që ta kemi një ligj të mirëfilltë. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupet tjera nuk ka të lajmëruar. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Pa dyshim se nevoja e rregullimit me ligj të Institutit për Administratë Publike duhet përshëndetet dhe është plotësisht në pajtim edhe me konceptin e reformës së Shërbimit Civil dhe reformës së Administratës Publike.

Të mos harrojmë se koncepti i ri i Shërbimit Civil kërkon që shërbyesit civilë të aftësohen gjatë gjithë karrierës dhe bazohet në parimin e meritokracisë, apo parimin e avancimit të shërbyesve civilë, varësisht nga performansa.

Dhe, Instituti për Administratë Publike është një institut i cili duhet t'u mundësojë shërbyesve civilë aftësi permanente me trendet më të reja në Shërbimin Civil dhe në Administratën Publike.

Mendoj se duhet sqaruar se ne nuk po krijojmë bazën për krijimin e një institucioni akademik të Administratës Publike, sepse nga buxheti i shtetit, i Republikës së Kosovës kemi dy programe në Universitetin e Prishtinës që përgatisin kuadro për Administratë Publike. Është programi bazik në Departamentin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike dhe është programi master në Fakultetin Juridik, ku ne përgatitim studentë të studimeve master për Administratë Publike.

Unë kam i tri kërkesa për këtë ligj, nuk ka dilemë që e përkrah. E para që kjo të jetë vetëm bazë që të fillojë reforma e këtij instituti, në atë mënyrë që ky institut të jetë me trendet më të reja të reformës së administratës publike. E kam thënë edhe javën e kaluar, ministër, kur e kemi diskutuar raportin vjetor të Shërbimit Civil, ka nevojë që komplet kurrikulat e këtij instituti të reformohen, sepse kam gjykim se janë akoma me konceptin e vjetër.

Ju e keni përgatitur edhe strategjinë e reformës së administratës publike, e cila është përditësuar, dhe kjo nënkupton që komplet instituti të reformohet në kuptimin e nevojave që parasheh strategjia dhe të ofrojë kurse dhe trajnime të kohës të kohës reale, e jo kurse në formë shablloni, për çdo vit të përsëriten kurset për prokurimin, për menaxhimin e resurseve publike, por për çdo vit të ofroj kurse të reja, në mënyrë që shërbyesit tonë të jenë në pozita udhëheqëse të nivelit të administratës qendrore dhe administratës lokale. Të jenë trendet më të reja të reformës së administratës publike.

Po e zëmë, zoti ministër, ju jeni përgjegjës për e-qeverisjen dhe ju sugjeroj që të kërkonit nga menaxhmenti i këtij instituti që të ofrojë së paku 2-3 programe të e-qeverisjes, të menaxhimit elektronik të administratës publike, në mënyrë që vërtet këto programe të

mundësojnë që shërbyesit civilë të përparojnë në karrierë. Pra, jo të stagnojnë, por të përparojnë në karrierë.

E dyta, duhet që këto certifikata që lëshohen nga Instituti i Administratës Publike të jenë të pranuar nga të gjitha institucionet kompetente dhe të krahasueshme, që janë të ngjashme në rajon dhe në Evropë për administratën publike.

Dhe, e treta, vërtet kërkohet që të rishikohen nevojat reale të Administratës së Republikës së Kosovës për trajnime specifike, për trajnime specifike të shërbyesve specifikë të administratës publike, në mënyrë që ky institut vërtet të jetë një institucion shumë i rëndësishëm, i cili do t'i plotësojë kërkesat dhe nevojat që ka procesi i reformës së administratës publike, që është një proces jetik për Republikën e Kosovës dhe që është një nga kriteret kryesore politike për aderimin e Kosovës brenda Bashkimit Evropian.

Edhe një herë dëshiroj të përshëndes ardhjen e këtij projektligji, dhe besoj që ndërmjet dy leximeve ka mundësi të sqarohen, ka mundësi të hiqen edhe dilemat që aty-këtu janë shfaqur nga disa deputetë dhe mendoj që po krijohet një bazë e mirë ligjore për zhvillimin e Institutit të Administratës Publike. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, e ka fjalën.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Pasi IKAP-i është krijuar si një Institut për Administratën Publike në vitin 2002 dhe atëherë vërtet e ka pasur një arsyeshmëri që të formohet për ta ndihmuar ngritjen e kapaciteteve në administratën e Kosovës, pasi ne e kemi një universitet në Prishtinë dhe shumë universitete në qytete të ndryshme të Kosovës, kemi edhe shumë universitete private të akredituara, konsideroj që ky institut i ka pushuar nevojat dhe planifikimi për ngritjen e kapaciteteve të administratës në aspektin profesional duhet t'u besohet institucioneve të larta arsimore.

Për faktin që politika që po udhëheq me këtë nuk po i dërgon atje njerëzit që e kanë dijen, që e kanë përgatitjen dhe që e kanë eksperiencën. Dhe, mund të them që pas dy-tre vjetëve puna e këtij instituti është degraduar dhe po t'i bëhet një analizë e mirë, do të duhet të shpërbëhej dhe planifikimi arsimor për administratën publike duhet t'u besohet institucioneve të larta të arsimit të lartë të Kosovës. Nuk ka asnjë arsye që ta kemi këtë institut brendapërbrenda Qeverisë së Kosovës.

Një çështje tjetër, konsideroj që Kosova do të duhej ta kishte një trup që do të merrej me vlerësimin e këtyre mekanizmave që i kemi krijuar gjatë këtyre viteve dhe që janë jofunksionale sot. Dhe, ka shumë borde, shumë këshilla, shumë komisione që mund të them - janë jofunksionale.

Gati çdo këshill i pavarur dhe shumica e bordeve të pavarura, ne do të ju njoftojmë një ditë për këtë, janë jofunksionale. Janë jo funksionale për faktin se nuk po funksionojnë

mbi bazën e ligjeve dhe kjo lidhja e propozimit të ministrive apo të Qeverisë për komisione të ndryshme nuk është në nivelin e përgjegjësisë dhe mund të themi se i kemi disa komisione tjera që janë jofunksionale.

Në anën tjetër, e them me përgjegjësi, ne jemi vendi më i vogël në rajonin tonë dhe në Evropë, dhe kemi shumë këso komisionesh të pavarura. E kemi një administratë të stërngarkuar.

Pasi po thirrrem te integrimet evropiane, në integrimet evropiane unë po ju them që me këtë administratë kështu të ngarkuar, ne mund t'i bëjmë qejf vetes, por nuk mund të integrohemi në institucionet evropiane. Është administratë shumë e madhe, joprofesionale. Dhe, pamundësia e Qeverisë dhe e institucioneve për t'i ngritur kapacitetet e investimeve, edhe të brendshme, edhe të jashtme, për të ngritur kapacitetet e absorbimit të fuqisë punëtore, jemi orientuar në administratë, dhe administrata e ka shumë vështirë ta absorbojë gjithë atë fuqi të madhe të të papunëve.

Prandaj, unë e them me përgjegjësi që ky IKAP i ka plotësuar të gjitha kushtet për t'u mbyllur dhe ngritja e kapaciteteve profesionale dhe administrative të administratorëve të nivelit lokal dhe të nivelit qendror t'u besohet institucioneve të arsimit të lartë, për të cilat mendoj se ka mjaft, vetëm se duhet të bëhet një programim i nevojave të administratës me institucionet e arsimit të lartë që e kemi në Kosovë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zot Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vërtet tash, pas fjalës suaj, sepse është një çështje, e cila është në thelb pak më ndryshe, unë nuk dëshiroj të deklaroj, sepse këtë ligj unë kam propozuar në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të Ligjit të shërbimit civil të nenit 10, ku thuhet që ekziston Instituti i Administratës Publike dhe është përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve për arsimimin dhe për aftësimin. Në këtë aspekt ka dalë ky ligj.

Ndërsa sa i përket idesë, edhe unë jam për ta hapur ndoshta gjatë reformës së Administratës Publike, edhe në Komisionin Ndërminstor për reformën e administratës publike, të bisedojmë, ose ta mendojmë si një ide të tillë.

Në anën tjetër, si ligj, është pjesë e arsimimit të vërtetë, i cili është ndoshta pjesa më e debatueshme dhe më e diskutueshme.

Është vizioni duke bazuar në ligj, sepse prapë unë jam duke u thirrur në ligjin, ku thuhet se bëhet edhe arsimimi, dhe ka dy lloj arsimimesh: arsimimi jashtë institutit, ku nevojitet të bëjmë arsimimin e kuadrove sesi do ta bëjmë.

Unë mund të ju deklaroj se në këtë moment disa institucione, edhe jashtë Ministrisë së Administratës Publike, edhe jashtë Institutit, kanë angazhime, ose kontrata sa i përket

arsimimit. Këtë çështje duhet ta rregullojmë me këtë ligj që arsimimi për nevojat e administratës publike të jetë, duke bazuar në ligjin.

Në anën tjetër, është edhe një vizion. Nuk është vetëm nga unë, është biseduar edhe me donatorët, por gjithashtu edhe me ekspertë të tjerë, që do të ishte mirë të mendohet edhe ky nen. Neni 10 është vetëm për një mendim për të ardhmen se a mund të bëhet, a mund të krijohet.

Në qoftë se dëshirojmë të bëjmë ngritjen e kapaciteteve, unë mendoj që duhet ta fillojmë prej disa hapave, dhe hapi i parë është aprovimi i ligjit, sepse funksionimi i Administratës Publike ose Institutit duhet të bëhet sipas ligjit, ndërsa, në anën tjetër, për përforcimin e kapaciteteve dhe arsimimin përsëri duhet ta kemi një dispozitë ligjore, e cila lejon dhe hap rrugën për atë rrugë.

Në anën tjetër, unë si ministër jam i gatshëm të bashkëpunoj në komisionin përkatës që kjo çështje të rregullohet. Por, është e rëndësishme që Ligji për Institutin e Administratës Publike të bëhet me ligj, sepse tash është duke funksionuar sipas udhëzimit administrativ dhe ka nevojë të bëhet ngritja e kompetencës, por edhe kapaciteteve të brendshme të Institutit.

Unë ju falënderoj për sugjerime dhe edhe një herë deklaroj që jam krejt i hapur për të biseduar edhe për atë nenin dhe ta rregullojmë si mendojmë, sepse edhe ligji do të jetë për mandatin tjetër, edhe për mandate tjera, në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kanë përfunduar diskutimet. Fjala e ministrit është e fundit. Vazhdojmë me votim. Të pranishëm janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 38 vota për, 19 kundër dhe 2 abstenime... Nuk i kemi 61 deputetë. Përsëritet votimi. Janë 83 kartela elektronike. 64 deputetë janë të pranishëm. Ju lutem, votoni, ose e lëmë për herën tjetër.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm fizikë janë 64, prania elektronike 80. Mund të shkojmë edhe një herë, po nëse nuk bëhen numrat, vazhdojmë. Prania elektronike është 80. Hiqini kartelat, të cilat janë tepër. Te unë janë 70 kartela të vendosura. Shërbimi teknik hiq kartelat që nuk janë këtu! Edhe dy kartela janë diku, edhe një.

Votojmë për praninë. Tani janë 62 deputetë.

Edhe një herë, lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 38 vota për, 18 kundër dhe 5 abstenime, miratohet në parim Ligji për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin numër 04/L-102

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka hartuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si pjesë e programit legjislativ për vitin 2013.

Ky projektligj është pjesë e aktiviteteve të Ministrisë së Financave për implementimin e legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me financat publike.

Njëra ndër çështjet kryesore të trajtuara nëpërmjet këtij projektligji është edhe zgjatja e mandatit të Bordit të Pavarur për Shqyrtime deri në fund të vitit të ardhshëm 2014.

Siç jeni në dijeni, nëpërmjet këtij ligji është rregulluar edhe funksionimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, i cili i trajton ankesat e bizneseve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganave të Kosovës, me cilësinë e shkallës së fundit, kurse nga janari i vitit 2013, ankesat e reja kanë kaluar në Divizionin Fiskal të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Mirëpo, mbi bazën e ligjit, Bordi është i obliguar t'i kryejë të gjitha lëndët që i kanë pranuar deri në fund të vitit 2012.

Bordi ende i ka mbi 1 000 lëndë të pazgjidhura, me gjithë faktin se është rritur intensiteti dhe volumi i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2013, gjë që realisht ka shënuar dyfishimin e aktiviteteve të tij, është e paraqitur nevoja që të zgjatet një mandat i tillë.

Është e nevojshme që mandati i anëtarëve aktualë të Bordit deri në përfundim të lëndëve të pranura dhe të pazgjidhura të zgjatet, të cilat sipas planit të propozuar nga Bordi, do të zgjidhen deri në fund të vitit 2014.

Ky projektligj gjithashtu e ka bërë thjeshtësimin e dispozitave ndëshkimore me anë të të cilave synohet rritja e nivelit të efektivitetit dhe të efikasitetit të mjeteve juridike për

tatimpaguesit, në njëërën anë, si dhe lehtësimin e implementimit të dispozitave ndëshkimore të ligjit.

Janë bërë edhe përmirësime teknike në dispozitat e projektligjit, të cilat do ta rritin efikasitetin e zbatimit të tij.

Në këtë drejtim, disa nga gjobat e parapara me ligjin në fuqi janë përshtatur sipas nivelit të shkeljeve nga tatimpaguesit në Republikën e Kosovës.

Konsiderojmë që miratimi i këtij ligji nuk do të ketë ndikim financiar në buxhetin e Republikës së Kosovës, përkundrazi vlerësojmë që amendamentet e propozuara do të kenë ndikim pozitiv, jo negativ për buxhetin, ashtu edhe për bizneset, të cilat kanë parashtruar ankesa pranë bordit përkatës.

Prandaj, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin numër 04/L-102.

Për të gjitha propozimet, të cilat do të vijnë, ne do të jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë ndërmjet dy leximeve për ta përmirësuar dhe për ta bërë një ligj sa më funksional, i cili do të mundësojë gjithë ato ankesa të cilat deri më tani kanë mbetur të pa trajtuara të trajtohen, por ta përmirësojnë edhe cilësinë e ligjit në fjalë.

Prandaj, edhe një herë i ftoj deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Hap debatin për diskutimin e ligjit në parim. Fjalën e merr kryetarja e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin numër 04/L-102, siç e tha edhe ministri, ka për qëllim zgjatjen e mandatit të Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave deri më 31 dhjetor 2014, për shkak të numrit të madh të lëndëve, të cilat nuk ka pas mundësi t'i zgjidhin.

Megjithatë, me plotësim-ndryshimet e Ligjit numër 04/L-102 për Administratën Tatimore dhe Procedurat është paraparë që nga 1 dhjetori 2012, organ kompetent dhe përgjegjës për t'i trajtuar ato ankesa është Divizioni fiskal i Departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili veç ka filluar punën.

Po ashtu, ky projektligj propozon disa ndryshime në dispozitat ndëshkimore dhe bëhet harmonizimi me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, thjeshtëson dispozitat ligjore dhe i bën më të kuptueshme dhe eviton disa gabime gjuhësore dhe teknike të cilat janë lëshuar në ligjin bazik.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 9 shtator e ka shqyrtuar plotësim-ndryshimin e këtij Ligji për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe ka vlerësuar se projektligji përmbush kushtet e domosdoshme formale- juridike të parapara në Rregulloren e Kuvendit që do të thotë se projektligji përmban memorandumën shpjegues për objektivat që synon t'i realizojë ligji dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Po ashtu projektligji përmban edhe deklaratën për ndikime buxhetore që vlerësohet pa kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe deklaratën për afrim dhe harmonizim me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane sipas të cilës konkludohet se dispozitat e Projektligjit nuk i cenojnë parimet e asquis communautaire të Bashkësisë Evropiane për financat publike.

Prandaj projektligji si i tillë i përmbushë kushtet për miratim në parim dhe Komisioni njëzëri i rekomandon Kuvendit të miratojë atë në parim dhe të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet që do të dalin do të adresohen lidhur me projektligjin që do të shqyrtohen me kujdes në Komisionin për Buxhet dhe Financa ku do të bëhet edhe amendamenti i tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja kryetare e Komisionit. Për Partinë Demokratike të Kosovës, e ka fjalën deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, i nderuar ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit numër 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe procedurat e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-102, dhe në parim do ta mbështesim.

Kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete!

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, e ka fjalën deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

E kemi shqyrtuar në komision dhe e kemi shqyrtuar edhe në Grupin Parlamentar dhe kemi konsideruar që ndryshimi i këtij ligji poentën kryesore e ka tek neni 25 që ka të bëjë me mandatin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.

Meqenëse ligji i përmendur është në fuqi, që kjo i është deleguar Departamentit fiskal të Administratës Gjyqësore edhe atëherë kemi menduar që ky Komision duhet t'i kryejë të gjitha lëndët dhe gjyqësia atëherë të fillojë nga fillimi, nga zero, por meqenëse nga volumni i madh dhe kompliciteti i këtyre ankesave ky komision e ka përfunduar vetëm

gjysmën e lëndëve dhe ne kemi konsideruar që nëpërmjet këtij ligji është mirë që t'i vazhdohet mandati edhe për një vit në kuptimin e asaj që gjysmës së Komisionit vetëm i skadon me 23 apo iu ka skaduar dhe pjesa tjetër e ka deri në nëntor. Kështu që me këtë veprim ne ua zgjasim mandatin edhe një vit.

Unë e di që procedurat e emërimit të Komisionit janë krejt ndryshe, por kjo është diçka e përkohshme dhe konsiderojmë që edhe proceduralisht është e mundur që me këtë ligj t'i krijohet mundësia përfundimit të gjitha lëndëve të cilat i shqyrton ky Komision, pasi që bartja e këtyre lëndëve tek gjykata do të krijonte edhe një komplicitet edhe më të madh. Prandaj, si Komision edhe si grup parlamentar ne e mbështesim këtë veprim të ministrit të Financave që nëpërmjet këtij ndryshimi të ligjit të mundësohet që të shqyrtohen të gjitha lëndët e pashqyrtuara dhe të startohet nga viti 2014 me lëndë të reja që do t'i shqyrtojë Gjykata e Qarkut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Për Lëvizjen "Vetëvendosje", deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne si Grup Parlamentar nuk do ta përkrahim këtë ligj për shkak se konsiderojmë që zgjatja e mandatit të Bordit për shqyrtimin e ankesave është e paarsyeshme. Ne të gjithë e dimë se këtij bordi i është zgjatur mandati për një vit, domethënë vitin e kaluar ne e kemi pasur një ligj të tillë në Kuvend ku e kemi shqyrtuar dhe megjithatë e kemi dhënë një mundësi që të paktën të kenë edhe një vit kohë dhe t'i shqyrtojnë të gjitha lëndët. Është dashur që të punojnë pak më seriozisht dhe t'i përfundojnë lëndët për shkak se nëse neve çdo vit na vijnë këtu ligje për zgjatjeve të mandateve vit pas viti dhe kur do të përfundojë kjo. Mendoj se kjo është jo serioze dhe ne si Grup Parlamentar nuk do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete!

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrahë në parim këtë plotësim-ndryshim, por e ka një kërkesë, po presim që viti 2014 të jetë fund, se bordi t'i kryejë të gjitha këto ankesa dhe mos të na vijë në Komisionin e Buxhetit dhe Kuvendit që t'i zgjatet mandati këtij bordi.

Unë shpresoj që ka afat të mjaftueshëm që me një azhuritë t'i kryejë të gjitha këto lëndë të cilat janë mbetur pa realizuar. Në parim Grupi i Aleancës do ta përkrahë.

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! E ka fjalën kryetarja e Grupit Koalicioni për Kosovën e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritet për dy ministrat,

Duke marrë parasysh rekomandimin e Komisionit parlamentar i cili ka ardhur në këtë seancë dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Komisioni për zgjatjen e mandatit për shqyrtimin e këtyre ankesave, ne si Grup Parlamentar do t'i japim përkrahje projektligjit dhe besojmë se Administrata Tatimore do të mund të arrijë që t'i plotësojë kërkesat të cilat i ka në shqyrtim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, nuk ka të tjerë që dëshirojnë të flasin për këtë projektligj. Ju njoftoj që nuk kemi kuorum për votim, por ne do të vazhdojmë, deri sa të mbledhen, do të kalojmë në pikën e shtatë dhe do ta diskutojmë ligjet dhe në fund do t'i votojmë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve ta paraqesë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar, profesor Hamiti!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të nderuar deputetë që para jush të paraqes për miratim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

Ministria e Drejtësisë e ka hartuar këtë projektligj në kuadër të prioritetëve të saja për reformimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë dhe për përf forcimin e kapaciteteve të Shërbimit sprovues të Kosovës.

Përmes këtij projektligji kemi synuar krijimin e një sistemi modern që i përgjigjet nevojave të vendit tonë, që në të njëjtën kohë është model konkurrues edhe me vendet e tjera të rajonit, por i përputhshëm edhe me standardet dhe praktikatat e vendeve të avancuara.

Qëllimi primar i këtij projektligji është rritja e sigurisë publike dhe garantimi i ekzekutimit më efektiv të vendimeve të gjykatave tona po edhe të panelit për lirim me kusht, përmes rregullimit me ligj të përdorimit të mbikëqyrjes elektronike gjatë procesit të zbatimit të drejtësisë penale në vendin tonë.

E gjithë kjo është duke i respektuar plotësisht dhe në çdo kohë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave të përfshirë në mbikëqyrje elektronike.

Janë disa nga kategoritë e personave për të cilat do të zbatohen këto projektligje.

E para, ky projektligj do të zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave ndaj të cilëve Gjykata ka vendosur masat e premtimit të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'u ofruar vendit apo personit të caktuar dhe arresti shtëpiak.

E dyta, në frymë të njëjtë mbikëqyrja elektronike do të zbatohet edhe për personat të cilëve u janë shqiptuar dënimet alternative, sikur që janë dënimi me kusht me urdhër dhe trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrjen nga Shërbimi sprovues.

Dhe, e treta, në kuadër të këtij projektligji është paraparë që mbikëqyrja e personave u është shqiptuar edhe urdhri i mbrojtjes apo urdhri për mbrojtje emergjente.

Organi përgjegjës për realizimin dhe mbikëqyrjen elektronike do të jetë Shërbimi sprovues i Kosovës, shërbim ky që është shndërruar në organ qendror dhe të pavarur nga Ministria e Drejtësisë, tani së fundmi pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Detyrat dhe obligimet e parapara me këtë ligj do të shkojnë edhe më tutje në përgjegjësi të këtij shërbimi dhe përgatitjet e duhura profesionale dhe administrative do të mundësojnë zbatimin në përpikëri të këtij ligji.

Për më tepër mbikëqyrja elektronike do të zbatohet duke respektuar rreptësisht dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe shumë parime tjera esenciale sikur që janë: parimi i ligjshmërisë, i mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike, garantimin e lirisë së personave dhe të dëmtuarit nga veprat penale apo edhe të viktimës, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, mos diskriminimi dhe proporcionaliteti i mbikëqyrjes elektronike me rrethana të rastit dhe personalitetin e tij si dhe personin që e kryen në mënyrë efektive këtë mbikëqyrje.

Është shumë me rëndësi të theksojmë se fakti që pajisjet do të vendosen në trupin e një personi nën mbikëqyrjen elektronike, sipas kushteve të parapara me ligj, do të jetë e përgatitur sipas standardeve të parapara dhe e njëjta nuk do të ketë asnjë efekt apo imazh negativ për shëndetin e tij, përkatësisht të ambientit social ku jeton ai.

Ne kemi qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm që këtë pikë duke tentuar që gjithnjë të kemi parasysh liritë dhe të drejtat e personave të garantuara me Kushtetutën e vendit tonë dhe në asnjë mënyrë ato të drejta mos t'i cenohen.

Të nderuar deputetë,

Nëse flasim në nivel teknik, mbikëqyrja elektronike do të funksionojë me një pajisje elektronike e cila do të jetë e lidhur me sallën operative ku do të monitorohet respektimi i vendimeve të Gjykatës dhe panelit për lirim me kusht dhe vendimet të cilat kanë të bëjnë me kufizimin e lëvizjes së lirë të personave.

Në nivel shpenzimesh, më lejoni të them se do të ketë ulje të madhe të shpenzimeve për kujdesin ndaj personave që janë në arrest shtëpiak apo të atyre që janë duke i kryer dënimet alternative.

Monitorimi i tillë padyshim që do të garantojë sigurime të lartë për qytetarët e Republikës së Kosovës që paraqet një qëllim parimor për të gjithë ne dhe iniciativat tjera ligjore.

Praktikisht përmes këtij monitorimi Shërbimi sprovues do të ketë gjithmonë personat që janë nën arrest shtëpiak në vuajtje të dënimeve alternative apo nën urdhrin për respektimin e ndalesave të caktuara që do të monitorohen 24 orë në ditë.

Me këtë rast çdo tendencë për kryerjen e veprës së re penale apo mosrespektimin e rregullave do të neutralizohet menjëherë nga organet e zbatimit të ligjit, respektivisht Policia e Kosovës e cila do të jetë e informuar automatikisht nëpërmjet qendrës së mbikëqyrjes.

Nëpërmjet kësaj forme të mbikëqyrjes këta persona do të jenë nën mbikëqyrje të përhershme dhe do të shërbejë që të evitojnë çdo shkelje eventuale që do të rrezikonte personin apo edhe sigurinë e personave të tjerë.

Rëndësi tjetër e këtij projektligji është patjetër edhe fakti që do të inkurajohet shqyrtimi më shumë i masave alternative dhe dënimeve me kusht nga organet kompetente të Kosovës.

Para se të përfundoj, më lejoni të theksoj se projektligji i tillë është i hartuar në plotësi me të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë që janë në Kosovë dhe natyrisht duke marrë parasysh edhe mendimet e ekspertëve vendorë.

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji për rregullimin dhe plotësimin e infrastrukturës në fushën e administrimit të drejtësisë penale në vendin tonë, duke pasur parasysh po ashtu qëllimin tonë të përbashkët për avancimin e standardeve për Shërbimin sprovues të vendit tonë, dhe ngritjen e kapaciteteve tona për mbikëqyrjen e zbatimit të drejtësisë penale, më lejoni të ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj në parim dhe duke i marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet tuaja më pastaj të miratojmë në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti zëvendëskryeministër Kuçi!

Hap debatin për diskutim në parim për këtë projektligj. Për LDK-në është paraqitur Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë jam i autorizuar edhe nga Komisioni për Legjislacion që të tregoj përkrahjen në parim që i është dhënë këtij projektligji për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

Njëherësh edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe mendon se kjo e avancon reformën në sistemin e drejtësisë dhe për këtë arsye neve i japim përkrahje në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjuam mendimin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion dhe të LDK-së. Për PDK-në flet deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike është shqyrtuar dhe analizuar ky projektligj. E kemi vlerësuar racionalitetin edhe shumë aspekte tjera pozitive të këtij projektligji dhe i kemi dhënë mbështetje të plotë, kontributin tonë të mëtutjeshëm do ta japim në procedurat e mëtejshme në Komision.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumë shkurt, edhe Grupi ynë Parlamentar e mbështet në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Ardian! Kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë këtë ligj dhe vërejtjet tona pastaj do t’i japim në Komision.

KRYESUESI: Faleminderit Visar! Për Koalicionin Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Aleanca Kosova e Re e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Nuk ka tjerë që dëshirojnë të flasin, por ne dëgjuam që të gjitha grupet që u prononcuan bashkë me Komisionin FunkSIONAL e përkrahin.

Po vazhdojmë sepse i kemi 60 deputetë, bëhen edhe 61, në pikën tjetër të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është hequr.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka mbikëqyr zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Suzan Novobërdaliu për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sot, në cilësi të kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, paraqes raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore, numër 2004/2, i datës 7 qershor 2004.

Bazat për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit janë Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73, vendimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, Raporti i Progresit për Kosovën të vitit 2011, Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i monitorimit është vlerësimi i zbatimit të Ligjit për barazinë gjinore në Kosovë 2004/2, ndikimi i tij në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gruas në organet legjislative dhe organet ekzekutive qendrore dhe lokale, institucionet dhe ndërmarrjet publike, shoqërinë civile e tjera.

Në këtë drejtim ne kemi përdorur intervistat e drejtpërdrejta në terren dhe pyetësorët e vet administruar për mbledhjen e të dhënave nga institucionet në tërë vendin, përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Në fund, raporti përmban propozimet për avancimin e Ligjit për barazinë gjinore.

Shfrytëzoj rastin ta falënderoj projektin e UNDP-së në Kuvend, për përkrahje të rëndësishme në tërë procesin e mbledhjes së të dhënave.

Në përgjithësi të dhënat tregojnë për përpjekjen institucionale në arritjen e barazisë gjinore dhe përparimin, veçanërisht në sferën e punësimit, sidomos në nivelin qendror. Procesi i zbatimit të këtij ligji po ballafaqohet me sfidat e vazhdueshme.

Disa nga sfidat kryesore të gjetura nga monitorimi janë:

- Niveli i ulët i punësimit të femrave në nivelin lokal,
- Niveli i ulët i barazisë dhe i promovimit të barazisë gjinore në pozitat udhëheqëse në të dy nivelet, pra në atë qendror dhe lokal,

- Niveli i ulët i raportimit të Qeverisë në Kuvend për çështje të barazisë gjinore në përputhmëni me obligimet ligjore,
- Niveli i ulët i integritetit të perspektivës gjinore në politikat, projektet dhe programet e dy niveleve të qeverisjes në vend në përputhshmëri me obligimet ligjore,
- Niveli i ulët i përfshirjes së zyrtarëve për barazi gjinore në përpilimin e politikave zhvillimore,
- Mungesa e linjave buxhetore për politikat gjinore në të dy nivelet e qeverisjes,
- Mungesa e indikatorëve gjinorë, treguesit e ndjeshëm gjinor në strategjitë sektoriale të dy niveleve të pushtetit, e tjera.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur me 17.7.2013 miratoi raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore dhe në mbështetje të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore t'i përfshijë ndryshimet si në vijim:

- Ndryshimi i nenit 3, paragrafi 3.2 ku pjesëmarrja e barabartë e një gjinie në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës ekzekutiv gjyqësor dhe institucionet publike është 40%, të zëvendësohet me 50%.

Ky propozim mbështetet në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, në vitin 2010 ku përqindja e popullsisë sipas gjinisë në vendbanimet urbane është 51,1% meshkuj dhe 49,9% femra, derisa në ato rurale 50,2% meshkuj dhe 49,8% femra.

Në pikën 1.2 propozojmë të bëhet plotësim-ndryshimi i nenit 3, të shtohet paragrafi ku do të parashihet se në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës ekzekutiv- gjyqësor dhe institucionet publike, numri i femrave në pozitat vendimmarrëse dhe në ato të menaxhimit të jetë 50%.

Të ndryshohet neni 5 si dhe në tërë tekstin e ligjit ku ka të bëjë me Zyrën për Barazi Gjinore, të zëvendësohet me emërtimin - Agjencia për Barazi Gjinore.

Të hiqen nenet 6, 7 e 8 të këtij ligji për arsye se në ligjin ekzistues ende figurojnë nenet e cekura të cilat parashohin zgjedhjen, kompetencat dhe financimin e institucionit të avokates për barazi gjinore deri sa me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2004/18 të njëjtat janë hequr.

Të bëhet plotësimi i nenit 17 të ligjit ekzistues. Në rast të shkeljes së ligjit do të përcaktohet organi kompetent që do të shqiptojë dhe ekzekutojë gjobën. Deri më tani nuk është bërë zbatimi i dispozitave ndëshkuese të parapara me këtë ligj, prandaj ato duhet të zbatohen.

Të bëhet plotësimi i ligjit me nen të veçantë ku obligohet Qeveria të ndajë një fond - vijë të veçantë buxhetore për çështje gjinore, në mbështetje të programeve, projekteve për aftësim profesional, politikat e punësimit të femrave në përgjithësi dhe në veçanti

shtrirjen e këtyre projekteve edhe në zona rurale, gjë që do të ndikonte në pavarësimin ekonomik të grave.

Të ngritët niveli i raportimit të Qeverisë në Kuvend për çështje të barazisë gjinore në përputhshmëri me nenin 4, paragrafi 4.4 dhe 4.5 të Ligjit për barazi gjinore.

Të realizohet niveli i integritit të perspektivës gjinore në politikat, projektet dhe programet e dy niveleve të pushtetit ekzekutiv në vend në përputhshmëri me nenin 4, paragrafët 4.7, 4.8, 4.9, 4.10, 4.11, 4.12 dhe 4.13 të Ligjit për barazi gjinore.

Të ngritët niveli i përfshirjes së zyrtarëve për barazi gjinore si në vendimmarrje e po ashtu edhe në zbatimin e propozimeve në hartimin e politikave zhvillimore ashtu siç është paraparë në nenin 4 paragrafi 4.16 ku për vendimet që marrin organet e qeverisjes lokale para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore edhe nga zyrtari apo zyrtarja për barazi gjinore në komunën përkatëse.

Të saktësohen raportet hierarkike të zyrtarëve për barazi gjinore të nivelit komunal.

Të ngritët niveli i bashkëpunimit ndërmjet të Agjencisë për Barazi Gjinore me nivelin komunal të qeverisjes lidhur me politikat gjinore.

Të ngrihet niveli i përfshirjes së zyrtarëve për barazi gjinore në këshilla dhe komisionet seleksionuese të përzgjedhjes në procesin e rekrutimit të stafit.

Të përcaktohen linjat e rregullat buxhetore për politikat gjinore dhe të bëhet mbikëqyrja e zbatimit të tyre në të dy nivelet e qeverisjes së ekzekutivit.

Të bëhet vendosja e treguesve të ndjeshëm gjinor në strategjinë sektoriale me qëllim të realizimit të barazisë gjinore si në punësim dhe vendimmarrje në nivelin qendror dhe atë lokal, por edhe në sfera tjera të angazhimit.

Dhe në fund, Qeveria duhet të zbatojë detyrimin ligjor dhe çdo dy vjet të raportojë në Kuvendin e Kosovës, për realizimin e programit të Kosovës për barazi gjinore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju ftoj që ta miratoni raportin me rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit! Për PDK-në flet Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar raportin për monitorimin e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përshëndet punën e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione.

Gjithashtu ne si Grup Parlamentar i rekomandojmë Kuvendit për miratimin e këtij raporti me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Izmaku! Në emër të LDK-së, ju them unë se e përkrahim këtë raport dhe do ta votojmë.

Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, flet deputetja Alban Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Analiza e gjendjes, pozitës dhe statusit që e gëzon më shumë se gjysma e shoqërisë mbetet i një rëndësie fundamentale, sepse në bazë të kriterëve që përdoren për këtë përkufizim strukturalist mund të definohet edhe vetë shoqëria jonë në përgjithësi.

Gjysma e popullsisë në Kosovë privohet nga e drejta themelore demokratike për të qenë dhe për t’u trajtuar si qytetarë të barabartë të shoqërisë.

Gratë i janë nënshtruar një diskriminimi sistematik që fillon në familje nëpërmjet ndarjes së punëve, ndërmjet rolit tradicional të gruas dhe atij të burrit e gjer të dhënia e shanseve më të mëdha ndaj burrave e djemve që në shkollim, e ky diskriminim gjinor vazhdon të shfrytëzimi në punë, mënjanimi nga pozita drejtuese në institucionet ekonomike dhe ato politike duke filluar nga komunat e duke përfunduar tek ministritë, Parlamenti e Qeveria. Një vend që përjashton gjysmën e popullsisë nga qeverisja nga puna, nga proceset e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, nga demokratizimi i vendit, heqë dorë nga gjysma e burimeve, shanseve dhe mundësive që ka për zhvillim.

Një trajtim i tillë i grave në Kosovë është një prej pengesave kryesore të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, edukimit të brezit të ri, zhvillimit demokratik dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Lëvizja “Vetëvendosje” angazhohet që gratë në Kosovë të jenë qytetare të barabarta të vendit me të gjitha të drejtat dhe obligimet që i garanton Kushtetuta. Kjo mund të arrihet nëse karshi të drejtave ligjore, karshi krijimit të kushteve për pjesëmarrjen e barabartë të gruas në të gjitha proceset shoqërore, zhvillohet edhe një debat i përgjithshëm shoqëror për emancipimin e burrit, i cili e krijon vlerën e të qenët i barabartë, pavarësisht nga përkatësia gjinore.

Një debat i tillë ka parasysh barazinë, trajtimin dhe mundësitë e njëjta për djalin dhe vajzën në familje dhe shoqëri që nga lindja e gjer në vdekje.

Në politikën afatshkurtër Lëvizja “Vetëvendosje” angazhohet për krijimin e kushteve të mbrojtjes institucionale të drejtave të gruas në familje e në shoqëri nëpërmjet fuqizimit të shërbimeve sociale, këshillëdhënëse, mbrojtjes juridike, mbrojtjes nga dhuna në familje,

përfshirjen në institucione të shtetit dhe shërbimeve të cilat krijojnë lehtësi për përkujdesjen ndaj fëmijëve për të bërë të mundshëm angazhimin e gruas jashtë familjes që nga ekonomia e deri në politikë, një gjë të cilën gjatë monitorimit të Ligjit për barazi gjinore e kemi vërejtur se nuk po respektohet.

Raportin për monitorimin e ligjit Lëvizja “Vetëvendosje” do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pra të Grupit të saj, flet deputetja Deputete Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar monitorimin e Ligjit për barazi gjinore dhe të njëjtin do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar ZB, deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala potpredsedniče!

U ime Parlamentarne grupe Zajednička budućnost, ja ću danas reći par stvari o izveštaju o Nacrtu zakona ravnopravnosti polova samim tim što smo aktivno učestvovali u izradi preporuka mi smo i razmotrili u Parlamentarnoj grupi iste. Smatramo da su preporuke jako umerne i da su u skladu sa mnogim evropskim konvencijama o zaštiti ljudskih prava i ravnopravnosti polova.

Nadamo se da će Vlada prilikom izrade novog i dopune istoimenog zakona imati u vidu ove preporuke. Kao što znamo, Kosovo ima problem sa implementacijom mnogih zakona, nadamo se da Nacrt zakona o ravnopravnosti polova i ove preporuke koje iznosi komisija za ljudska prava neće ostati samo mrtva tačka na papiru već da će se potpuna implementacija, kada kažemo ravnopravnost polova, i poštuje na samom terenu. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kymete Bytyçi e ka fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë. Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë raport. Gjendja e barazisë gjinore nuk është e mirë në Kosovë, shumë shihet qartë, në bazë të dhënave që ka shkelje të drejtave të grave në shumicën e institucioneve shtetërore dhe private.

LDK-ja e përkrah këtë raport për barazi gjinore dhe rekomandimet e dhëna anë raport dhe ju bëj thirrje të gjitha institucioneve që t'i marrin shumë seriozisht rekomandimet e Komisionit të dhëna në raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kymete! Fjalën e ka kërkuar deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nuk e kisha mendjen të flas, mirëpo më intrigoj fjala e koleges deputete nga radhët e “Vetëvendosjes”, sepse kolegia nga radhët e “Vetëvendosjes” tha më herët se kjo Lëvizje angazhohet për të drejta të barabarta të dy gjinive. Dhe kur jemi te këto të drejta unë vetëm dua të rikujtoj edhe një herë rastin që një përfaqësues i kësaj Lëvizjeje e bëri para dy-tri ditësh brenda institucionit të KQZ-së, kur e fyeu rëndë udhëheqësen zonjën Valdete Daka, edhe pse ky përfaqësues i Lëvizjes “Vetëvendosje” kërkoi falje, kjo falje nuk e justifikon atë veprimin që ky e bëri, prandaj unë kërkoj që ato që thuhën dhe deklarohen brenda këtij Parlamenti dhe brenda Lëvizjes “Vetëvendosje” se po punojnë shumë për promovimin dhe liritë e gruas, mendoj se këto duhet të angazhohen që përfaqësuesit e tyre të sillen konform këtyre ligjeve për të cilat të gjithë ne angazhohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Për ta prishur pak edhe strukturën e diskutuesve për barazinë gjinore, folën vetëm përfaqësues të një gjinie dhe flasim për barazinë. Megjithatë dua, duke pasur parasysh edhe kohën në të cilën po diskutojmë, të shpreh respektin për punën që është bërë, të mbështes raportin, por kam një vërejtje të cilën dua ta shtroj edhe pse rrezikoj ndoshta të moskuptohem mirë.

Për të provuar që ta reduktoj këtë mundësi moskuptimi, dëshiroj të theksoj faktin se e mbështes pa rezerva, pa hezitim çdo përpjekje që është në funksion të avancimit të pozitës së gruas. Kur flasim për barazinë gjinore, për fat të keq ne ende jemi detyruar të flasim për nevojën e barazimit të gruas në shoqërinë tonë.

Nuk kam këtu asnjë rezervë, vërejtja ime është që kjo nuk bëhet vetëm me deklarime, nuk bëhet vetëm me formula, me shifra. Dhe, në raport e në rekomandime kemi disa propozime që dalin jashtë suazave të raportit për zbatimin e ligjit. Raporti për zbatimin e ligjit përfshinë vlerësimet sa po zbatohet ligji ekzistues dhe eventualisht pastaj atje ku ka dështime me rekomandime synohet të përmirësohet ajo. Kjo nuk e përjashton edhe nevojën e përmirësimeve të nevojshme në ligj, por në rastet kur konstatohet se dispozitat ligjore janë pengesë për zbatimin e ligjit, frymës së ligjit.

Po a është te ne kjo siç del në raport, ta zëmë, fakti që përsëritet aq shpesh nga 40% të rritet pjesëmarrja e gruas në segmente të ndryshme shoqërore në 50%. Është një synim i drejtë, por a e kemi realizuar këtë që e kemi me ligj 40%-shin dhe derisa nuk e kemi realizuar 40%-shin çka përmirësojmë nëse e bëjmë në letër 50%? “S’bëhet vreshta me urata, por me shata e lopata”- thotë një fjalë e urtë e popullit. Nuk përmirësohet pozita gjinore - barazia shoqërore e gruas në shoqërinë tonë vetëm me formula, duhen përpjekje të gjithanshme.

Prandaj unë sugjeroj që të bëjmë përpjekje që ta realizojmë kaq sa është dhe pastaj të synojmë ta ngremë edhe në 50% pse jo, por të krijojmë iluzionin se me rritjen e

përqindjes ne po e përmirësojmë pozitën, megjithatë mendoj që nuk mjafton. Besoj se do të kuptohem drejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Hyseni! E fundit, fjalën e merr deputetja Alma Lama, pa grup parlamentar.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë mbështes plotësisht raportin dhe rekomandimet dhe punën e shkëlqyer që e ka bërë ky Komision për të monitoruar Ligjin për barazi gjinor edhe ashtu sikur që e ka parë secili deputet në rast se e kanë lexuar atë çfarë konstaton raporti, shifrat janë alarmante.

Jo vetëm që s'bëhet fjalë për barazi dhe përafrim të barazisë ose të konceptit të barazisë, por bëhet fjalë për një diskriminim të jashtëzakonshëm.

Tani unë e di që shumëkush flet, madje edhe ky Parlament, janë shumë të gatshëm të flasin në mënyrë pozitive, por kur është puna për të mbrojtur me të vërtetë interesat e grave e që janë edhe interesa të lirisë në përgjithësi, të gjithë e fusin kokën në rërë.

Ju përkujtoj këtu rastin e hoxhës nga Prizreni ku shumica e këtyre deputetëve heshtën dhe disa madje i dolën në mbrojtje.

Në lidhje me rekomandimet për 50%-shin. Është e vërtetë që nuk është respektuar as 40%-shi, por të mos harrojmë kërkesa për 50% ka bazë pikërisht në këtë Kuvend të Kosovës, i cili ka miratuar përpara, në fillim, në fakt në fund të vitit të kaluar një rezolute që ka të bëjë me objektivat e njëvjeçarit dhe objektiv i këtij njëvjeçari është që deri në vitin 2050 në shkallë botërore, madje, të luftohet që së paku në institucione të arrihet ky nivel i barazisë 50 me 50. Dhe mendoj se duke iu përshtatur kësaj rezolute mbase duhet të fillojmë të ndryshojmë edhe ligjet dhe Ligji për barazi gjinore të mos jetë 40% po të bëhet 50%. Edhe po kështu, kuota në Parlamentin e Kosovës mos të jetë 30% që është edhe në shpërputhje me ligjin, por të bëhet 50 me 50, sepse masat afirmative janë shumë të nevojshme duke pasur parasysh diskriminimin, po e themi, dymijëvjeçar ndaj grave, kështu që e mbështes plotësisht raportin dhe mendoj që duhet të fillojmë të ndryshojmë edhe ligjin që t'ia përshtatim këtij qëllimi. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, Alma për këtë hiperbolë kohore! Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, nënkryetar!

Pasi u përmend në disa raste edhe Qeveria dhe besoj që edhe kemi arsye që të japim sqarimin tonë.

E para besoj, që në fillim po e them, se Qeveria e merr shumë seriozisht raportin dhe me siguri do të tentojë që ta implementojë në praktikë. Por, zakonisht kur përgatisim raporte të tilla, është mirë t'i shohim dy anët e medaljes dhe është mirë që prezantimet tona jo vetëm për qytetarët e vendit tonë, por në veçanti për prezantimet tona që mund të

përdoret ky raport edhe për ndërkombëtarët dhe të tjerët, të mos themi edhe disa gjëra që janë vetëm keq, por disa mirë.

E para, në bazën legale që e ka Kosova, ne që nga Kushtetuta, duhet ta pranojmë një fakt, jemi më të avancuar se të gjitha shtetet tjera të rajonit. Madje po e them, në një nen të Kushtetutës thuhet, kur të dy kandidatët janë me poenë të njëjtë apo në kushte të barabarta, fiton kandidati i gjinisë femër. Do të thotë këtë duhet ta kemi parasysh. Bazën legale e kemi më mirë se të tjerët.

E dyta, besoj edhe bazën institucionale e kemi më mirë se të tjerët dhe është mirë të thuhet se në këtë vend presidentja është femër, deputete ka. Dhe unë besoj po ashtu të merret si anë pozitive dhe të mos e sheh dikush shoqërinë e Kosovës si shoqëri të pa emancipuar.

Çka duhet të bëjmë më shumë jo vetëm në zbatimin e ligjit, në mendimin strukturor të shoqërisë lidhur me barazinë gjinore. Edhe këtu s'mjafton vetëm Qeveria, s'mjafton vetëm Kuvendi, por mjafton pak më shumë njerëz.

Kur e them më shumë njerëz, kam parasysh familjen, rrethin, vendet e rajonit dhe besoj se të gjithë duhet të angazhohemi në këto drejtime.

Natyrisht duhet ta pranojmë një fakt, kur gjendja e përgjithshme nuk është e mirë, cenimi më i madh u bëhet strukturave ose grupeve të cënueshme, grave, fëmijëve dhe pleqve. Nëse ne kemi një papunësi, atëherë ta kemi parasysh që në atë papunësi me siguri pleqtë janë më së keqi, fëmijët janë më së keqi dhe gratë më së keqi. Pra të punojmë edhe për gjendjen e përgjithshme ta përmirësojmë dhe jo vetëm një segment.

Dhe sot e përmendi zoti Hyseni me të drejtë. Nuk më pëlqeu pak ajo që vetëm femrat dolën me e mbrojtur raportin, se barazia gjinore nuk nënkupton vetëm barazi për femrat, por barazi për të gjithë dhe në këtë drejtim mendoj që të gjithë duhet të jemi të qartë.

Natyrisht, unë kërkoj po e them prapë, besoj edhe Qeveria po edhe bashkë me ju deputetë, të bëjmë më shumë në ndryshimin e mendimit strukturor për barazinë gjinore të vendit tonë. Nuk është keq, nuk duhet të jemi ata që duhet të vajtojmë në këtë drejtim, por unë besoj se femrat duhet ta kuptojnë një çështje, po flas si baba i tri vajzave. Përveç se kanë avantazhe me ligj e me Kushtetutë, eja ta përgatisim shoqërinë për konkurrencë dhe të jenë konkurrencte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Deputetë të nderuar, ne i diskutuam të gjitha pikat e rendit të ditës dhe po vijmë te faza e votimit.

Ju lutem për prani t'i prekni tastierat. Pra, votoni për prani. A ka dikush që s'ka kartelë? 1, 2. Të pranishëm janë 54 deputetë. Zotërinj deputetë, të gjitha pikat janë diskutuar, mbeten të votohen në një mbledhje të ardhshme kur ta caktojë Kryesia. Faleminderit për bashkëpunim!

* * *

Më 2 tetor 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 19 shtator dhe të vazhduar më 26 shtator
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 26 shtator 2013.

Konstatoj se prania elektronike deri më tani është 65 deputetë, pa kartela i kemi 67. Tani i kemi 68 me kartela dhe dy pa kartela - 72 janë gjithsej.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE

Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, nenit 18 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës parasheh se Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare. Pra, duhen gjithsej 80 deputet për votim. Pra, ratifikimi i marrëveshjes kërkon së paku 80 vota për, ndërsa neni 60, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit parasheh se procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin për Financa, zotin Besim Beqaj, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar i kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës ka synim kryesor rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shtrirjen e subjektivitetit të saj ndërkombëtar nëpërmjet anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare.

Në këtë funksion, pas një lobimi të suksesshëm që ka zhvilluar Qeveria e Republikës së Kosovës, Bordi i Drejtorëve i Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, më 14 qershor 2013, nëpërmjet miratimit të një rezolute i ka hapur rrugë anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës.

Sidoqoftë, deri në anëtarësimin e plotë në këtë institucion të rëndësishëm financiar ndërkombëtar, Republika e Kosovës duhet t'i përmbushë disa kushte, ndër të cilat është

edhe ratifikimi i neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, që nënkupton ratifikim të neneve, të cilat e kanë themeluar marrëveshjen, e kanë themeluar Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Prandaj, miratimi i këtij ligji ka për qëllim krijimin e kushteve ligjore për kryerjen e procedurave të anëtarësimit të Republikës në Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Pas miratimit të këtij ligji, Qeveria e Kosovës do të vazhdojë përmbushjen e obligimeve tjera, duke përfshirë obligimet financiare, me qëllim të anëtarësimit të plotë të Republikës së Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Duke e konsideruar si një hap jashtëzakonisht të rëndësishëm drejt rritjes së bashkëpunimit në institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat hapin perspektivë ekonomike të fondeve zhvillimore për Republikën e Kosovës dhe gjithashtu duke konsideruar se është një hap i rëndësishëm në shtrirjen e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë Projektligjin për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Faleminderit!

KRYETARI: Tani fjala është për kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj. Nuk është këtu. Në emër të komisionit, fjalën e ka kërkuar Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar draft-marrëveshjen në komision dhe konsiderojmë se është e dobishme për interesat e Kosovës, edhe në aspektin material, por edhe në aspektin politik, që ka të bëjë me integritet tona në institucione ndërkombëtare.

Me gjithë atë që e ka një kosto buxhetore, meqë duhet të paguhet një shumë e caktuar në rata, ne konsiderojmë se për çështjet sociale dhe çështjet tjera të infrastrukturës, është më se e nevojshme që të jemi pjesë e këtij institucioni bankar evropian dhe nenet e ofruara të aprovohen në Parlament.

Ne i përkrahim dhe do t'i votojmë si të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Ju folët edhe në emër të grupit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në këtë bankë dhe duke pasur parasysh mundësitë, të cilat kjo marrëveshje ia ofron Kosovës, si dhe fillimin e

procedurave për një anëtarësim të tillë, Grupi ynë Parlamentar e vlerëson pozitivisht dhe do të jemi pro këtij ratifikimi. Faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj se të pranishëm janë 95 deputetë, edhe prania elektronike, edhe fizike. Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah këtë ligj dhe do ta votojë.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziri e ka fjalën.

XHAVDET NEZIRI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës e përkrah këtë marrëveshje dhe është në dobi të vendit, prandaj me këtë qëllim votat e Grupit të Aleancës do të jenë për këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke e marrë si të rëndësishme çështjen e Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re i jep përkrahje, për arsye se të gjitha dobitë nga kjo marrëveshje do të shkojnë në favor të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nakon razmatranja Nacrta zakona o ratifikaciju članova Osnovnog sporazuma o banki za razvoj Saveta Evrope, učlanjene Kosova u njemu, parlamentarna grupa “6 +” podržava ga i glasa se za njega.

KRYETARI: Në emër të Grupit të SLS-së, kryetari Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke će glasati za ratifikaciju ovog sporazuma.

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, kryetari Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” održava usvajanje Nacrta zakona, i glasaće za njegovo usvajanje.

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka të lajmëruar për fjalë, atëherë shkojmë në votim. Ju njoftoj se prania është 95 deputetë, fizike dhe elektronike. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 90 vota në mënyrë elektronike, 2 me ngritje dore, gjithsej 92, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/BL- 222 për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102

Diskutimet për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin, nr. 04/L-102, kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 26 shtator 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit, votimi i këtij projektligji është shtyrë. Pra, ka mbetur vetëm që të votojmë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim Votojmë, tash!

Konstatohet se me 75 vota për, 9 kundër, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Tani radha është për pikën e tretë:

3. Votimi i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht

Diskutimet për shqyrtim në parim të Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike dhe personat të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 26 shtator 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit, votimi i këtij projektligji është shtyrë.

Tani votojmë për këtë ligj. I lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 91 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Në radhë e kemi pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore

Diskutimet për shqyrtimin e raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 26 shtator 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit, votimi i këtij raporti është shtyrë për sot.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 89 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Pika e fundit e rendit të ditës është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, të Ujërave, të Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Mjedisit, të Ujërave, të Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, deputetin Nait Hasani, ose të autorizuarin e Komisionit. Nëse jo, atëherë vazhdojmë votimin e amendamenteve. Nga Komisioni Funksional janë të propozuara gjithsej 32 amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.
Votojmë tash!

Konstatoj se me 87 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, të Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë